

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XVIII, nr. 5585  
E martë, 25 shtator 2018  
çmimi 0.40 €

Limaj: Në dialog do të diskutohet për të zhdukurit dhe dëmshpërblimet e luftës



IFAQE 6

Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)

facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

FLET PËR "EPOKËN E RE", GAZMEND SYLA IFAQE 4-5

## Do ta hedhim poshtë aktakuzën ndaj veteranëve të UÇK-së



Kryetari i Degës së Organizatës së Veteranëve të Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (OVL-UÇK) në Pejë, Gazmend Syla, ka bërë me dije se protesta e së mërkurës, e cila do të mbahet në Prishtinë, dhe që do të organizohet nga OVL e UÇK-së së Dukagjinit, ka për qëllim mbrojtjen e vlerave të luftës dhe dinjitetit të luftëtarit të UÇK-së. Ai ka thënë se përmes kësaj proteste do të kundërshtohet aktakuza e prokurorisë në rastin "Veteranët", e cila, sipas Sylës, fyen luftëtarët dhe luftën çlirimtare. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka thënë se do ta hedhin poshtë këtë aktakuzë në mënyrë që t'i hapet rruga një hetimi të ri. Sipas Sylës, hetimi i veteranëve nuk ka qenë serioz dhe ka pasur për qëllim degradimin e luftës çlirimtare. Ai ka bërë me dije se në këtë fazë nuk pritet t'u ndalen pensionet atyre veteranëve që, sipas prokurorisë, janë 'veteranë të rrejshëm'.

ISA MUSTAFA KA MBAJTUR TAKIM ME GRUPIN PARLAMENTAR DHE KRYESINË E LDK-së IFAQE 3

### LDK-ja synon rrëzimin e Qeverisë me mocion, jo me protesta



MSA-ja nuk po zbatohet sa duhet

IFAQE 7

HIQET MASA NDËSHKUESE QË AUTOMJETI I BLERË TË REGJISTROHET NGA E PARA F. 3

### EKONOMI

MBI 5 MILIONË EURO KREDI PËR TRAJTIMIN E UJËRAVE TË ZEZA NË PODUJEVË F. 9

KOSOVËS I THELLOHET DEFICITI TREGTAR F. 8

### KULTURË



MINISTRI GASHI: VITI 2019 DO TË JETË VIT I NDRYSHIMIT TË MADH PËR RININË F. 11

### SPORT

GASHI: DETYRA IME ËSHTË TA RIKTHEJ BESËN NË SUPERLIGË F. 16

TREPÇA '89 BESON TEK MAGANI F. 16

**RENOVA**  
PUTZ  
Magedoni  
Xhepçisht-Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**  
[www.kolegijbiznesi.com](http://www.kolegijbiznesi.com)  
info@kolegijbiznesi.com  
038 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë, Vasa, p.n Prishtinë, Kosovë,  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302  
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

**DINO**  
Konjuh Lipjan, Magj. Prishtinë Ferizaj-Kosovë  
tel & fax +381 38 566 666



# Agjenda e delegacionit të Kosovës në OKB, afirmimi i shtetësisë

Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, dhe ministri i Punëve të Jashtme, Behgjet Pacolli, në kuadër të punimeve të Asamblesë së Përgjithshme të Organizatës së Kombeve të Bashkuara (OKB) kanë nisur takimet me personalitete të vendeve të ndryshme. Ata janë takuar me kryeministrin e Samoas nga i cili kanë kërkuar votën e këtij shteti për anëtarësimin e Kosovës në organizatat ndërkombëtare

## "Epoka e re"

**NJU JORK, 24 SHTATOR** - Delegacioni zyrtar i Republikës së Kosovës, i përbërë nga presidenti Hashim Thaçi, kryeministri Ramush Haradinaj dhe ministri i Punëve të Jashtme, Behgjet Pacolli, tashmë gjenden në Nju Jork, në kuadër të punimeve të Asamblesë së Përgjithshme të Organizatës së Kombeve të Bashkuara (OKB). Siç ka njoftuar Ministria e Punëve të Jashtme, delegacioni i Kosovës do të ketë dhjetëra takime me homologë nga të katër anët e globit. "Objektivat kryesorë të kësaj agjende janë afirmimi i shtetësisë së Kosovës, anëtarësimi në organizata të ndryshme ndërkombëtare, forcimi i marrëdhënieve dypalëshe politike, ekonomike etj., vendosja e marrëdhënieve diplomatike me vende të caktuara dhe njohje të reja", është thënë në njoftimin e MPJ-së.

Të hënën, gjatë punimeve të Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së, kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, i shoqëruar edhe nga ministri i Jashtëm, Behgjet Pacolli, është takuar me kryeministrin e Samoas, Susuga Tuilaepa Sailele Malielegaoi. Haradinaj ka thënë se Kosova është mirënjohëse që shteti i Samoas e njohu pavarësinë e Kosovës dhe tani vota e këtij shteti, anëtare e OKB-së, është tejet e nevojshme për fuqizimin ndërkombëtar të vendit.

Gjatë takimit kryeministri Haradinaj e ka njoftuar homologun Malielegaoi për progresin e Kosovës që nga shpallja e pavarësisë më 2008 e deri më tani, për orientimin pro-perëndimor dhe

për rrugën e saj drejt integriteteve euroatlantike. "Republika e Kosovës është e përkushtuar në rrugën e saj euroatlantike dhe për këtë është duke bashkëpunuar ngushtë me partnerët e saj ndërkombëtarë për shtimin e numrit të njohjeve, forcimin e subjektivitetit ndërkombëtar dhe anëtarësimin në organizata të fuqishme ndërkombëtare", ka deklaruar kryeministri Haradinaj, duke kërkuar nga kryeministri Malielegaoi përkrahjen e tij dhe të shtetit të tij për shtimin e njohjeve për Kosovën dhe anëtarësimin në institucionet ndërkombëtare. Më tej, kryeministri Haradinaj e



ka njoftuar për zhvillimet politike në Kosovë dhe rajon, për zhvillimin ekonomik, sundimin e rendit dhe të ligjit dhe për aspekte të tjera me rëndësi për vendin dhe qytetarët e saj. Kryeministri Haradinaj ka thënë se Republika e Kosovës ka krijuar raporte të mira me shumë vende dhe në këtë drejtim, drejt fuqizimit të subjektivitetit

ndërkombëtar është i mirëpritur edhe avancimi i raporteve bilaterale me Samoan.

Kryeministri i Samoas, Susuga Tuilaepa Sailele Malielegaoi, ka përgëzuar kryeministrin Haradinaj për arritjet e shtetit të Kosovës në këtë dekadë të pavarësisë, duke thënë se Samoa do të jetë përkrahëse e Kosovës për anëtarësim në organizata

ndërkombëtare, duke shprehur përkushtimin e shtetit të tij që t'i forcojë edhe më shumë marrëdhëniet bilaterale mes dyja vendeve. Punimet e sesionit të 73-të të Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së janë duke u ndjekur me vëmendje të madhe nga mediet botërore për shkak të pranisë të shefave të shteteve më të fuqishme të botës.

## Krerët shtetërorë takojnë senatorin Johnson, konfirmohet mbështetja e ShBA-së

Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, së bashku me kryeministrin Ramush Haradinaj dhe ministrin e Punëve të Jashtme, Behgjet Pacolli, si dhe ambasadorin e Kosovës në ShBA, Vlera Çitaku, janë takuar me senatorin amerikan Ron Johnson, ku kanë biseduar për rrugëtimin e Kosovës drejt lirisë, pavarësisë dhe procesit të shtetndërtimit.

Këtë e ka bërë të ditur presidenti Thaçi, ku ka thënë se ShBA-ja do ta mbështesë Kosovën edhe për në arritjen e një marrëveshjeje përfundimtare me Serbinë në kuadër të fazës së fundit të dialogut. "Sapo përfunduar një takim me mikun e Kosovës, senatorin Ron Johnson. Senatori Johnson, duke i shërbyer SHBA-së, ka mbështetur rrugëtimin tonë drejt lirisë, pavarësisë dhe procesit



të shtetndërtimit. Të njëjtën mbështetje të ShBA-së do ta kemi edhe këtyre ditëve në agjendën tonë për shtimin e njohjeve, anëtarësimin në organizata ndërkombëtare dhe arritjen e një marrëveshjeje përfundimtare me Serbinë, në kuadër të fazës së fundit të dialogut", ka shkruar ai në profilin e tij në "Facebook".

Për këtë takim ka njoftuar edhe zyra e kryeministrit e Republikës së

Kosovës. Në takim me senatorin Johnson, kryeministri Haradinaj e ka njoftuar atë për progresin e arritur në vend, veçmas në fushën e rendit dhe ligjit dhe përkushtimin e Qeverisë për fuqizimin ndërkombëtar të vendit, anëtarësimin në organizatat ndërkombëtare, punën drejt transformimit të FSK-së në Ushtri dhe tema të tjera me interes për vendin. Kryeministri Haradinaj ka theksuar

se Kosova është e përkushtuar që ta forcojë partneritetin bilateral me Shtetet e Bashkuara të Amerikës në çdo fushë me interes për të dyja vendet, duke ritheksuar qëndrimin e Qeverisë për miqësinë e përjetshme me ShBA-në dhe orientimin e pakthyesëm euroatlantik, thuhet në njoftimin e Zyrës së kryeministrit. "ShBA-ja ishte krahnesh në secilën etapë të shtetndërtimit tonë dhe orientimi ynë si vend është krahnesh politikave të miqve tanë", ka thënë kryeministri Haradinaj.

Ndërsa senatori Johnson ka përshëndetur angazhimin e Qeverisë së vendit në tema të ndjeshme për sigurinë dhe ka shprehur gatishmërinë për ta përkrahur vendin në proceset integruese dhe anëtarësimin në organizatat ndërkombëtare.

## Baza e NATO-s në Kuçovë, e vetmja në rajon

**TRANË, 24 SHTATOR** - Krijimi i bazës ajrore të NATO-s në Kuçovë, si e vetmja bazë e Aleancës në Ballkanin Perëndimor, dëshmon seriozitetin dhe rolin e shqiptarëve si faktor stabiliteti për paqen dhe sigurinë në rajon. Kështu

deklaroi të hënën ministrja shqiptare e Mbrojtjes, Olta Xhaçka, e cila vlerësoi stërvitjen shumëpalëshe Albanian Lion 2018, ndërsa theksoi rolin e Shqipërisë në Aleancë. "Ne do të vazhdojmë t'i përmbushim detyrimet tona ndaj NATO-s,

ku Shqipëria mbetet vend me kontribute të qenësishme. Ne mbështesim të gjitha iniciativat e Aleancës dhe tashmë pas 9 vjetësh anëtarësim në NATO, vendi ynë është transformuar në një vend që po kontribuon në Aleancë", shtoi Xhaçka.





Isa Mustafa ka mbajtur takim me grupin parlamentar dhe kryesinë e LDK-së

# LDK-ja synon rrëzimin e Qeverisë me mocion, jo me protesta



Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) është e përkushtuar ta rrëzojë Qeverinë Haradinaj me anë të mocionit të mosbesimit dhe jo nëpërmjet protestave. Kështu është bërë me dije të hënën pas takimit që ka pasur kryetari i LDK-së, Isa Mustafa, me grupin parlamentar dhe kryesinë e kësaj partie. Pas këtyre takimeve, nënkryetari i LDK-së, Agim Veliu, ka thënë se është një disponim i mirë i të gjithë mekanizmave të LDK-së që të punojnë bashkërisht drejt rrëzimit të kësaj qeverie. Veliu ka bërë me dije se LDK-ja nuk do ta mbështesë protestën e paralajmëruar nga Lëvizja Vetëvendosje

në konsultime edhe me subjektet e tjera politike. Nuk jemi larg këtij qëllimi, por na duhet edhe pak kohë të punojmë në mënyrë që t'i definojmë të gjitha çështjet që janë të lidhura me organizimin e një veprimi kaq të rëndësishëm për Kosovën", ka thënë Veliu. Lidhur me protestën e Lëvizjes Vetëvendosje ai ka thënë se LDK-ja nuk e përkrah atë ngaqë, sipas tij, ende nuk është koha për protesta.

Ai ka treguar se protesta mund të vijë në shprehje vetëm nëse dështon mocioni. "LDK-ja nuk është kundër shprehjes së vullnetit të qytetarëve, qoftë edhe përmes protestave. Ne si kryesi nuk e kemi vlerësuar se është momenti i duhur që ta thërrasim anëtarësinë e LDK-së për protesta, sepse mendoj se na kanë mbetur edhe dy-tri veprime që mendojmë se duhet t'i bëjmë brenda institucioneve dhe pastaj vjen hapi i fundit që është protesta, të cilën nuk e përjashtojmë. Por nuk do t'i përgjigjemi ftesës së Vetëvendosjes. Ne kur e thërrasim protestën e organizojmë vetë atë", është shprehur ai, duke shtuar se kur LDK-ja ta dalë në rrugë nuk do të kthehet më në institucione. "Në organet tona vendimmarrëse të LDK-së do ta diskutojmë edhe mundësinë e protestës. Për ne protesta është hapi i fundit, sepse nëse ne dalim në rrugë atëherë LDK-ja nuk kthehet në këto institu-

cione derisa ato të legjitimohen me votën e qytetarëve", ka thënë Veliu.

Ndërsa shefi i grupit parlamentar i LDK-së, Avdullah Hoti, ka përsëritur se institucionet aktuale nuk mund ta drejtojnë procesin e dialogut me Serbinë. "Ky është procesi më i rëndësishëm që po kalon Kosova pas dhjetë vjetëve si shtet i pavarur dhe institucionet e vendit nuk kanë legjitimitet për ta udhëhequr këtë proces. Neve na vjen mirë që dy ditët e fundit ka pasur vlerësime të partnerëve tanë kryesorë ndërkombëtarë, që Kuvendi i Kosovës tashmë

nuk i ka dhënë askujt legjitimitetin, sepse nuk ka fuqi politike brenda Kuvendit për t'i dhënë dikujt legjitimitet për t'i udhëhequr këto institucione dhe se zgjedhjet janë të pae-vitueshme për ta nxjerrë një qeveri kredibile e legjitime që flet në emër të shumicës së qytetarëve", ka thënë Hoti. Sipas tij, rrëzimi i këtyre institucioneve arrihet vetëm me konsistencë të opozitës. "Unë jam i bindur që me një konsistencë dhe bashkërendim të aktiviteteve të krejt opozitës ne mund t'i ndalim këto veprime të dëmshme", është shprehur Hoti.

**EPOKA E RE****Muhamet KOCI**

**PRISHTINË, 24 SHTATOR** - Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) mbetet e përkushtuar që vendi të shkojë sa më shpejt në zgjedhje të reja, duke e rrëzuar me mocion Qeverinë aktuale. Për këtë qëllim lideri i LDK-së, Isa Mustafa, të hënën ka takuar grupin parlamentar dhe kryesinë e kësaj partie. Nënkryetari i LDK-së, Agim Veliu, dhe shefi i grupit parlamentar i këtij subjekti politik, Avdullah Hoti, kanë treguar se janë duke punuar me subjektet e tjera politike që ta përgatisin mocionin e mosbesimit për Qeverinë e kryeministrit Ramush Haradinaj. "Është një disponim i mirë i të gjithë mekanizmave të LDK-së që të

punojmë bashkërisht drejt rrëzimit të kësaj Qeverie sa më shpejt që është e mundur. Do të punojmë edhe me subjektet e tjera politike në mënyrë që ta përgatisim edhe një mocion sa më shpejt dhe vendin ta çojmë drejt zgjedhjeve. Ju e dini se qëndrimi i LDK-së prej fillimit të vitit është se vendi është në një krizë politike dhe institucionale, pasi këto institucione nuk kanë legjitimitet as politik dhe as kushtetues, si dhe nuk kanë mundësi të udhëheqin me tema që janë të ndjeshme për Kosovën e të cilat janë në interes për të gjithë qytetarët", ka thënë Veliu pas takimit me grupin parlamentar të LDK-së. Ai është shprehur optimist se për këtë qëllim do të gjejnë edhe mbështetjen e partive të tjera politike. "Ne vazhdimisht jemi

## LDK-ja formon grup punues për përgatitjen e platformës së dialogut

Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) ka formuar një grup punues për përgatitjen e platformës së dialogut me Serbinë. Përmes një komunikate për medie, pas takimit të kryetarit të LDK-së, Isa Mustafa, me grupin parlamentar dhe kryesinë e LDK-së, kjo parti ka treguar për qëllimet e këtij grupi punues. "Çështja e dialogut mbetet temë kryesore e kryesisë së LDK-së, me ç'rast u formua

një grup i punës për platformën e dialogut, e cila jep korniza të qarta se si duhet të vazhdohet dialogu. Po gjatë takimit të kryesisë u formua edhe një grup punës i cili do të punojë rreth platformës zgjedhore. LDK-ja mbetet e përkushtuar që vendi të shkojë sa më shpejt në zgjedhje dhe të përmbushen të gjitha interesat e qytetarëve të Kosovës", është theksuar në komunikatën e LDK-së.

## Hiqet masa ndëshkuese që automjeti i blerë të regjistrohet nga e para

**PRISHTINË, 24 SHTATOR** - "Në grupin punues për Ligjin e Automjeteve kalon iniciativa për plotësim-ndryshimin e

Ligjit dhe hiqen masat ndëshkuese ndaj qytetarëve që, sipas ligjit aktual, automjetin e blerë duhet ta regjistro-

jnë nga e para!", kështu ka bërë me dije të hënën deputeti i AAK-së, Muharrem Nitaj. Ai ka thënë se shumë shpejt qyte-

tarët me bartjen e pronësisë e bartin edhe regjistrimin pa pasur nevojë të paguajnë taksa shtesë.





Flet për "Epokën e re", Gazmend Syla

# Do ta hedhim poshtë aktakuzën



Kryetari i Degës së Organizatës së Veteranëve të Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (OVL-UÇK) në Pejë, Gazmend Syla, ka bërë me dije se protesta e së mërkurës, e cila do të mbahet në Prishtinë, dhe që do të organizohet nga OVL e UÇK-së së Dukagjinit, ka për qëllim mbrojtjen e vlerave të luftës dhe dinjitetit të luftëtarit të UÇK-së. Ai ka thënë se përmes kësaj proteste do të kundërshtohet aktakuza e prokurorisë në rastin "Veteranët", e cila, sipas Sylës, fyen luftëtarët dhe luftën çlirimtare. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka thënë se do ta hedhin poshtë këtë aktakuzë në mënyrë që t'i hapet rruga një hetimi të ri. Sipas Sylës, hetimi i veteranëve nuk ka qenë serioz dhe ka pasur për qëllim degradimin e luftës çlirimtare. Ai ka bërë me dije se në këtë fazë nuk pritet t'u ndalen pensionet atyre veteranëve që, sipas prokurorisë, janë 'veteranë të rrejshëm'

## **EPOKA E RE** Shqipe HETEMI

**PRISHTINË, 24 SHTATOR** - Kryetari i Degës së Organizatës së Veteranëve të Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (OVL UÇK) në Pejë, Gazmend Syla, të hënën u ka bërë thirrje bashkëluftëtarëve dhe të gjithë qytetarëve të protestojmë kundër padrejtësisë së radhës që i bëhet luftës së shenjtë të UÇK-së. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka thënë se protesta e së

mërkurës që do të mbahet në orën 13:00 te Pallati i Drejtësisë në Veternik - Prishtinë ka për qëllim mbrojtjen e vlerave të luftës dhe dinjitetit të luftëtarit të UÇK-së. "Qëllimi i protestës së 26 shtatorit është kundërshtimi i aktakuzës së Prokurorisë në rastin 'Veteranët', kundërshtimi i fyerjeve që ua bënë luftëtarëve dhe luftës çlirimtare", është shprehur Syla. Ai ka thënë se pret pjesëmarrje masive në protestën e së mërkurës ani pse kjo protestë nuk ka përkrahje nga Kryesia

Qendrore e OVL të UÇK-së. "Deri më tani ka një përkrahje për protestën nga Shoqata e Invalidëve të Luftës (ShIL) dhe Shoqata e Familjeve të Dëshmorëve (ShFD) të UÇK-së në nivel qendror, si dhe shumë degë të OVL të UÇK-së. Nuk e dimë arsyen pse nuk ka përkrahje nga Kryesia Qendrore e OVL të UÇK-së. Po presim mbështetje nga të gjithë veteranët. Kemi marrë mesazhe mbështetëse nga e tërë Kosova", ka theksuar Syla. Ai ka thënë se do ta hedhin

poshtë komplet aktakuzën ndaj veteranëve në mënyrë që t'i hapet rruga një hetimi të ri. Sipas Sylës, hetimi i veteranëve nuk ka qenë serioz, por ka pasur për qëllim degradimin e luftës çlirimtare. "Nuk jam vetëm unë. Kam plot bashkëluftëtarë në atë listë. Në fakt, njoh shumicën prej tyre personalisht. Kjo tregon se hetimi nuk ka qenë serioz, ka qenë tendencioz për ta minimizuar dhe degraduar luftën çlirimtare. Ne mendojmë që do të arrijmë ta hedhim poshtë komplet këtë aktakuzë të pabazë, e mandej një hetim i ri të sqarojë nëse ka pasur lëshime gjatë procesit të verifikimit", ka deklaruar ai. Syla ka bërë me dije se në këtë fazë nuk pritet t'u ndalen pensionet veteranëve që, sipas prokurorisë, janë veteranë të rrejshëm.

**"Epoka e re":** Z. Syla, Organizata e Veteranëve të Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (OVL UÇK) në Dukagjin ka paralajmëruar protestë për të mërkurën, më 26 shtator. Mund të na tregoni se cili është qëllimi

i kësaj proteste?

**Syla:** Qëllimi i protestës së 26 shtatorit është kundërshtimi i aktakuzës së Prokurorisë në rastin 'Veteranët', kundërshtimi i fyerjeve që ua bënë luftëtarëve dhe luftës çlirimtare. Protesta do të mbahet në orën 13:00 te Pallati i Drejtësisë në Veternik - Prishtinë dhe ka për qëllim mbrojtjen e vlerave të luftës dhe dinjitetit të luftëtarit të UÇK-së.

**"Epoka e re":** Pse veç veteranët e Dukagjinit kanë organizuar këtë protestë, pra nuk është bërë nga niveli qendror i OVL UÇK-së?

**Syla:** Deri më tani ka një përkrahje për protestën nga Shoqata e Invalidëve të Luftës (ShIL) dhe Shoqata e Familjeve të Dëshmorëve (ShFD) të UÇK-së në nivel qendror, si dhe shumë degë të OVL të UÇK-së. Nuk e dimë arsyen pse nuk ka përkrahje nga Kryesia Qendrore e OVL të UÇK-së.

**"Epoka e re":** Prisi mbështetje edhe prej zonave të tjera?

**Syla:** Po presim mbështetje nga



# En ndaj veteranëve të UÇK-së



## GSPJ kërkon rritjen e punës së prokurorisë në rastet e korrupsionit

PRISHTINË, 24 SHTATOR - Grupi për Studime Juridike dhe Politike (GSPJ) ka prezantuar raportin "Monitorimi i Planit Strategjik të KPK-së: Ku po qëndron sistemi prokurorial në luftën kundër korrupsionit dhe krimin ekonomik?", në lidhje me atë se sa po qëndron sistemi prokurorial në luftën kundër korrupsionit dhe krimin ekonomik.

Bardha Maxhuni, autore e raportit, ka thënë se në bazë të afateve ligjore shumë prej rasteve janë në rrezik që të parashkruhen. "Bazuar se si janë proceduar kallëzimet penale gjatë periudhës 2016-2018, vërejmë se një numër i konsiderueshëm i kallëzimeve penale për vitin 2017 nëpër të gjitha prokuroritë është hedhur poshtë, me arsyetimin se nuk përfshinë elementet e parapara. Duke pasqyruar një mungesë të profesionalizimit në aspektin elementar, shpeshherë vë në dyshim qëllimin e vërtetë se pse këto aktakuza janë të paqëndrueshme. Në këtë drejtim kemi edhe një numër të vogël të aktakuzave të ngritura ku për vitin 2017 vetëm 40 për

qind kanë rezultuar në aktakuza të ngritura", ka thënë ajo.

Maxhuni ka listuar rekomandimet e kësaj organizate lidhur me këto çështje. "Si rezultat i të gjeturave kemi ardhur në këto rekomandime: për komisionin mbikëqyrës të ofrojë pasqyrë të plotë të lëndëve të korrupsionit të viteve 2001-2013 dhe informata lidhur me mënyrën se si janë proceduar ato, gjithashtu të ndërmerren masa disiplinore ndaj prokuroreve që janë treguar neglizhentë në punën e tyre", ka thënë Maxhuni.

Agim Maliqi, gjyqtar i Gjykatës Supreme të Kosovës, ka thënë se ka pasur rritje sa i përket trajtimit të rasteve. "Nëse krahasojmë raportet e muajit gusht 2017 dhe muajit gusht 2018, kemi një progres në trajtimin e këtyre lëndëve, dhe është një numër prej 47 lëndëve më pak se vitin e kaluar. Ne kemi edhe dy projekte shumë të rëndësishme që do të hyjnë më detale të rishikimit, eventualisht të lëndëve të cilat janë përfunduar në aktgjykime të formës së prerë. Normalisht kjo do të shikohet prej perspek-

tivës se sa janë trajtuar seriozisht nga prokurori i shtetit dhe gjykata e shkallës së parë, së dytë dhe të tretë. Shumë lëndë mund të vjetërohen për shkak të mostrajtitimit të tyre, një numër i caktuar i lëndëve me vite të tëra mund të mbeten në prokurori, pastaj me një periudhë kohore të barten në gjykatë", ka thënë Maliqi.

Ehat Maliqi nga Instituti Kosovar i Drejtësisë (IKD) ka pohuar se, sipas të dhënave të këtij instituti, kanë vërejtur se mbi 70 raste janë mbyllur nga prokuroria pa u dërguar në gjykatë. "Në bazë të monitorimit strategjik të IKD-së vërehet se mbi 70 raste dërgohen nga policia në prokurori, të njëjtat mbyllen nga prokuroria, pa u dërguar në gjykatë. 50 për qind të rasteve shtyhen pasi që mungojnë prokuroret", ka thënë Maliqi.

Gjatë tryezës ai ka përmendur edhe rastin e veteranëve mashtrues që, sipas Maliqit, publikimi i të dhënave personale është i paligjshëm dhe se shtimi i numrit mbi 1 000 veteranë të vërtetë është bërë për t'u dëmtuar rasti.

të gjithë veteranët. Kemi marrë mesazhe mbështetëse nga e tërë Kosova.

**"Epoka e re":** Deri më tani ka pasur mjaft deklarata lidhur me numrin e veteranëve në përgjithësi, por edhe të Dukagjinit në veçanti. Sipas jush, sa është numri i veteranëve dhe a prisni që kërj këta veteranë të marrin pjesë në protestën e së mërkurës?

**Syla:** Numrin e luftëtarëve mund ta dinë komandantët, secili për njësitin e vet. Në këtë rast për Zonën Operative të Dukagjinit mund ta pyesni ish-komandantin e zonës, sot kryeministër, Ramush Haradinaj. Përkrahja është nga të gjithë veteranët, mundësia për pjesëmarrje në protestë është tjetër. Të punësuarit dhe të moshuarit nuk presim që të vijnë por, gjithashtu, pjesëmarrja kufizohet edhe nga mundësia e degëve të OVL-së për ta siguruar transportin. Megjithatë, presim një pjesëmarrje masive.

**"Epoka e re":** Si e komentoni

faktin që edhe ju jeni pjesë e listës së veteranëve të rrejshëm?

**Syla:** Nuk jam vetëm unë. Kam plot bashkëluftëtarë në atë listë. Në fakt, njoh shumicën prej tyre personalisht. Kjo tregon se hetimi nuk ka qenë serioz, ka qenë tendencioz për ta minimizuar dhe degraduar luftën çlirimtare.

**"Epoka e re":** Z. Syla, ka rrezik t'ju ndalen pensionet të ashtuquajturve "veteranë të rrejshëm"? Nëse po, cilët janë hapat që do të ndërmerreni në këtë drejtim?

**Syla:** Në këtë fazë jo. Ne mendojmë se do të arrijmë ta hedhim poshtë komplet këtë aktakuzë të pabazë, mandej një hetim i ri të sqarojë nëse ka pasur lëshime gjatë procesit të verifikimit. Mos harroni se pas regjistrimit të popullsisë, projekti i verifikimit të veteranëve është më i madhi që ka ndodhur ndonjëherë në Kosovë dhe normalisht se mund të kenë ndodhur lëshime, që nuk janë aq të mëdha sa pretendon Prokuroria.





## Limaj: Në dialog do të diskutohet për të zhdukurit dhe dëmshpërblimet e luftës

PRISHTINË, 24 SHTATOR (ER) - Zëvendëskryeministri i Kosovës, Fatmir Limaj, ka pritur të hënën në një takim ambasadorin e Austrisë në Kosovë, Gernot Pfandler, me të cilin ka biseduar për zhvillimet e tanishme në vend dhe dialogun Kosovë - Serbi. Limaj ka bërë me dije se në fazën finale do të diskutohet për çështjen e të zhdukurve dhe dëmshpërblimet e luftës, kurse objektiv

kryesor është arritja e marrëveshjes përfundimtare. Ai ka treguar se e ka njoftuar ambasadorin Pfandler për përpjekjet e Qeverisë që Kosova të flasë me një zë në këtë proces të dialogut me Serbinë. "Kosova është gjithmonë për dialog me të gjitha vendet, e posaçërisht me Serbinë, për t'i mbyllur temat e hapura. Në fazën finale presim të diskutojmë për çështjet, si: të zhdukurit dhe dëmsh-

përblimet e luftës, ndërsa si objektiv kryesor është arritja e marrëveshjes përfundimtare e cila për ne nënkupton njohjen e Kosovës nga Serbia si dhe anëtarësimin e Kosovës në OKB dhe organizma të tjerë ndërkombëtarë", ka thënë zëvendëskryeministri Limaj. Ai ka theksuar se Austria ka marrë kryesimin e Bashkimit Evropian dhe ambasadori Pfandler ka ofruar mbështetjen e plotë.



## Udhëheqësit e lartë të EQAR-it vlerësojnë punën e ministrit Bytyqi



EPOKA  
ERE **Arbisa SHEFKIU**

PRISHTINË, 24 SHTATOR - Ministri i Arsimit, i Shkencës dhe i Teknologjisë, Shyqiri Bytyqi, ka pritur të hënën në takim presidentin e EQAR-it, Karl Dittrich dhe drejtorin e EQAR-it, Colin Tuck, me të cilët ka biseduar për punën që po bëhet dhe planet për ngritjen e cilësisë në arsimin e lartë. Ministri Bytyqi ka falënderuar

udhëheqësit e lartë të Regjistrimit Evropian për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë (EQAR), për kontributin që kanë dhënë që arsimi i lartë ta ketë rrugën hapur drejt integritimit evropian. Ministri ka theksuar se janë në rrugë të mbarë të reformave për të krijuar standarde më të larta dhe për të bërë hapa të rëndësishëm drejt integritimit evropian. "Në këtë drejtim, përkrahja juaj dhe këshillat tuaja janë shumë të rëndësishme dhe të

nevojshme", ka thënë Bytyqi. Ministri Bytyqi ka folur edhe për gjendjen në universitetet publike dhe private të Kosovës. Ai ka theksuar të arriturat që janë bërë, por edhe sfidat që hasen në këtë nivel të arsimit. "Jemi angazhuar për krijimin e infrastrukturës ligjore që AKA-ja të funksionojë tërësisht e pavarur dhe infrastrukturës shtesë ligjore që Agjencia të jetë e pavarur gjatë kontrollit të cilësisë në arsimin e lartë", ka deklaruar

ministri Bytyqi. Ndërsa presidenti i EQAR-it, Karl Dittrich, ka thënë se i çmon përpjekjet e MASHT-it dhe të Agjencisë së Kosovës për Akreditim për përmirësimin e cilësisë në arsimin e lartë. Presidenti dhe drejtori i EQAR-it u shprehën tejet të lumtur me përkushtimin e MASHT-it në funksion të pavarësisht të AKA-së dhe për krijimin e kushteve për funksionim të pavarur të këtij institucioni. Ata

shprehën besimin e tyre se me këtë angazhim AKA-ja shumë shpejt do të jetë pjesë e instancave kryesore të arsimit të lartë në Evropë. Presidenti Dittrich e ka ftuar MASHT-in të jetë vëzhgues në asamblatë dhe mbledhjet e tjera të rëndësishme të EQAR-it, për të qenë në rrjedha me zhvillimet ndërkombëtare në arsimin e lartë dhe këto ndryshime pozitive t'i aplikojë në Kosovë.

## Ministri Gashi takohet me ambasadorin francez: Siguria në Kosovë, stabile

PRISHTINË, 24 SHTATOR (ER) - Ministri i Punëve të Brendshme, Bejtush Gashi, ka pritur të hënën në takim ambasadorin e Republikës së Francës në Kosovë, Didier Chabert, me të cilin kanë diskutuar për bashkëpunimin mes dy shteteve, sidomos atë policor. Me këtë rast ministri Gashi e ka njoftuar ambasadorin Chabert për situatën e përgjithshme të sigurisë në Kosovë, duke vlerë-

suar se situata e përgjithshme e sigurisë është e qetë. Ai vuri në dukje angazhimet që do po bëhen sa i përket luftimit të krimit të organizuar dhe korrupsionit. Ndërsa ambasadori francez ka vlerësuar të arriturat në Kosovë dhe u shpreh i gatshëm për vazhdimin e bashkëpunimit të mirë që ka ekzistuar mes dy vendeve, sidomos sa i përket bashkëpunimit policor mes dy

vendeve. Në këtë takim u bisedua edhe për procesin e liberalizimit të vizave për përkushtimin e MPB-së për plotësimin e kriterëve dhe për menaxhimin pas procesit të liberalizimit të liberalizimit të vizave. Me këtë rast, ministri Gashi ka theksuar se janë bërë përgatitjet e duhura që të njoftohen qytetarët se cilat janë përparësitë dhe përgjegjësitë pas liberalizimit të vizave.





Mbahet takimi i Komitetit Punues për Integritime Evropiane

# MSA-ja nuk po zbatohet sa duhet



Ministrja e Integritimit Evropian, Dhurata Hoxha, në takimin e Komitetit Punues për Integritime Evropiane, ka kërkuar të hënën më shumë angazhim nga të gjitha institucionet për ta përmbyllur me sukses implementimin e prioriteteve të mbetura të Agjendës Evropiane të Reformave si dhe masave të parapara me MSA-në. "Plani Kombëtar për Zbatimin e MSA-së është i dobët. Nuk është realizuar. Të gjeturat e raportit janë shqetësuese. Jemi zotuar që këtë vit të arrijmë një nivel zbatimi të programit të MSA-së të paktën 60 për qind", ka thënë Hoxha

Zbatimin e MSA-së (PKMZSA) për të cilat ka thënë se duhet punuar më shumë. "Plani Kombëtar për Zbatimin e MSA-së është i dobët. Nuk është realizuar. Të gjeturat e raportit janë shqetësuese. Jemi zotuar që këtë vit të arrijmë një nivel zbatimi të programit të MSA-së të paktën 60 për qind. Mosrealizimi i planit do të ketë ndikim për mbështetjen e drejtpërdrejtë buxhetore për reformën e administratës publike", është shprehur ajo.

Ministrja Hoxhaj ka bërë me dije se deri në fund të qershorit janë zbatuar vetëm 12.78 për qind e të gjitha masave të planifikuara. Kurse sa i përket gjendjes së zbatimit të reformave legislative, ajo ka thënë se të gjeturat tregojnë se kemi arritur një shkallë zbatimi prej vetëm 18.06 për qindësh, pasi që janë zbatuar vetëm 26

nga 144 masat legislative të planifikuara. "Sa i përket zbatimit të reformave të tjera, të gjeturat tregojnë se është arritur një shkallë zbatimi prej vetëm 10.82 për qind, pasi janë realizuar vetëm 42 nga 388 masat zbatuese të planifikuara", ka theksuar Hoxha, duke shtuar se vazhdimisht Ministria e Integritimit Evropian ka dërguar letra njoftuese për masat që secili institucion ka obligim në programin e MSA-së. "Sërish rezultatin e kemi mjaft dobët. Komiteti punues ka karakter teknik. Pas këtij takimi do të mbledhim sërish Këshillin Ministror ku, bashkë me kryeministrin, do të kërkojmë raportime nga ministrat se ku qëndrojmë me zbatimin e programit", ka thënë ajo.

Hoxha ka ftuar anëtarët e Komitetit Punues për Integritime

Evropiane që të fokusohen të gjithë në masat për përmirësimin e zbatimit të programit të MSA-së, në mënyrë që të arrihet zotimi prej 60 për qindësh, edhe pse kanë mbetur vetëm pak muaj deri në fund të vitit.

Ministrja Hoxha ka prezantuar edhe ekspertin e GIZ-it, Aleksandar Pejoviq, i cili sjell ekspertizën e vet dhe përvojat e Malit të Zi në proceset e integritetit dhe MSA-së, duke ftuar të pranishmit të përfitojnë nga përvoja e tij dhe praktikave të mira të vendeve të tjera. Anëtarët e Komitetit Punues për Integritime Evropiane referuan rreth angazhimit dhe përqindjes së realizimit të Planit Kombëtar të MSA-së për secilën ministri dhe agjenci të pavarur, duke shprehur sfidat e procesit, por edhe duke u zotuar se përqindja e zbatimit do të arrihet sipas zotimit.

EPOKA  
ERE

Muhamet KOCI

PRISHTINË, 24 SHTATOR - Komiteti Punues për Integritime Evropiane ka mbajtur të hënën takimin e radhës në të cilin kanë marrë pjesë anëtarët e këtij komiteti. Ministrja e Integritimit Evropian, Dhurata Hoxha, ka kërkuar më

shumë angazhim nga të gjitha institucionet për ta përmbyllur me sukses implementimin e prioriteteve të mbetura të Agjendës Evropiane të Reformave si dhe masave të parapara me MSA-në. Hoxha ka theksuar se ky grup punues ka identifikuar disa prej çështjeve kyçe që dalin nga obligimet e Planit Kombëtar për

## Kosova finalizon kërkesën për reformën e administratës publike me Komisionin Evropian

EPOKA  
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 24 SHTATOR - Pas një procesi gjithëpërfshirës të konsultimeve dhe kontributeve nga Zyra e Kryeministrit si dhe Ministria e Integritimit Evropian, Ministria e Administratës Publike ka finalizuar kërkesën për këstin e parë prej 5.5 milionë eurosh nga kontrata për reformën sektoriale për reformën e administratës publike, e cila është nënshkruar midis Kosovës dhe Komisionit Evropian vitin e kaluar. Kërkesa e finalizuar i është dorëzuar zyrtarisht të hënën ministres së Integritimit Evropian, Dhurata Hoxha, për ta

deponuar te Komisioni Evropian.

Ministri i Administratës Publike, Mahir Jaghillar, ka deklaruar se me miratimin e projektligjit për pagat, projektligjit për zyrtarët publikë si dhe projektligjit për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore dhe agjencive të pavarura, si dhe me ndërmarjen e hapave të parë drejt zbatimit të procesit të racionalizimit të agjencive të pavarura, Kosova ka plotësuar kushtet kryesore për t'ia dorëzuar Komisionit Evropian kërkesën për këstin e parë prej 5.5 milionë eurosh nga kontrata për reformën sektoriale për reformën e administratës pub-



like.

Ministri Jaghillar ka thënë se nënshkrimi dhe fillimi i zbatimit të kontratës për reformën sektoriale për reformën e administratës publike shënon një arritje të rëndësishme për procesin e reformës së administratës pub-

like si dhe avancohet marrëdhëniet midis Kosovës dhe BE-së në fushën e administratës publike. "Kjo kontratë është tregues i arritjeve të Kosovës dhe besimit që Komisioni Evropian ka në kapacitetet e Qeverisë së Kosovës për ta menaxhuar një kontratë të

tillë", ka thënë ministri Jaghillar. Kontrata për reformën sektoriale për reformë në administratë publike është një instrument i ri që përdor Komisioni Evropian për t'i nxitur dhe mbështetur reformat në vendet e Ballkanit Perëndimor. Shuma e përgjithshme e kontratës është 25 milionë euro, ndërsa Kosova mund të përfitojë çdo vit deri në 5.5 milionë euro nëse arrin t'i plotësojë kushtet përmes kontratës. Buxheti përkatës dis-bursohet drejtpërdrejt në Thesarin Kombëtar të Kosovës duke i mundësuar Qeverisë burime të reja financiare për t'i financuar reformat dhe politikën zhvillimore.



# Kosovës i thellohet deficit tregtar

Sipas Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK), të dhënat nga tregtia e jashtme në Kosovë tregojnë për një deficit tregtar më të lartë për 4.5 për qind në muajin gusht të këtij viti, në raport me periudhën e njëjtë të vitit 2017, gjegjësisht në vlerë prej 276,5 milionë eurosh, krahasuar me deficitin prej 264,6 milionë eurosh në vitin 2017



EPOKA E ALBULENA S. MAVRAJ

PRISHTINË, 24 SHTATOR - Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) ka publikuar të hënën të dhënat lidhur me rrjedhat e eksportit dhe importit për muajin gusht të këtij viti. Sipas ASK-së, të dhënat nga tregtia e jashtme në Kosovë tregojnë për një deficit tregtar më të lartë për 4.5 për qind në muajin gusht të këtij viti, në raport me periudhën e njëjtë të vitit 2017, gjegjësisht në vlerë prej 276,5 milionë eurosh krahasuar me deficitin prej 264,6 milionë eurosh në vitin 2017.

Kurse eksporti mbulon importin me 9.9 për qind. "Eksporti i mallrave në muajin gusht 2018 kishte vlerën 30,4 milionë euro, ndërsa importi 307 milionë euro, që është një rënie prej -6.5 për qindësh për eksport dhe rritje prej 3.3 për qindësh për import, duke krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2017. Sipas të dhënave të grupeve kryesore të eksportit: 24.9 për qind të eksporteve të përbëjnë metalet bazë dhe artikujt prej tyre; 17.4 për qind e përbëjnë produktet minerale; 15 për qind e përbëjnë ushqimet e përgatitura, pijet dhe duhani; 12 për qind e përbëjnë plastika, goma dhe artikujt prej tyre; 9.7 për qind e përbëjnë produktet bimore; 4.2

për qind e përbëjnë makineritë, pajisjet mekanike dhe elektrike; 3.8 për qind e përbëjnë artikujt e ndryshëm të prodhuar etj", është thënë në raportin e ASK-së, duke shtuar se, sipas të dhënave të grupeve kryesore për import, 17.1 për qind e përbëjnë produktet minerale; 14.3 për qind e përbëjnë ushqimet e përgatitura, pijet dhe duhani; 12 për qind e përbëjnë metalet bazë dhe artikujt prej tyre; 10.6 për qind e përbëjnë makiner-

itë, pajisjet mekanike dhe elektrike; 6.7 për qind e përbëjnë mjetet e transportit; 6.3 për qind e përbëjnë produktet e industrisë kimike; 6.2 për qind e përbëjnë plastika, goma dhe artikujt prej tyre; 4.8 për qind e përbëjnë kafshët e gjalla, produktet me origjinë kafshe etj. "Eksportet e Kosovës në vendet e BE-së arritën në 10,5 milionë euro ose rreth 34.5 për qind të eksporteve të përgjithshme, me një rritje prej 31.4 për qindësh. Partnerët kryesorë për eksportin e mallrave në BE janë: Gjermania (7.2 për qind), Sllovenia (5.5 për qind), Britania e Madhe (4.7 për qind), Holanda (3.6 për qind) etj", thuhet në raportin e ASK-së.

Sipas ASK-së, importet e Kosovës nga vendet e BE-së ishin rreth 128,2 milionë euro ose 41.8 për qind e importeve të përgjithshme, me një rritje prej 5 për qindësh. Importet me pjesëmarrje më të lartë ishin nga: Gjermania (11.1 për qind), Italia (6.5 për qind), Rumania (4.1 për qind), Greqia (3.3 për qind), Polonia (3.2 për qind) etj. "Në muajin gusht 2018, eksportet e Kosovës me vendet e CEFTA-s arritën në 15,4 milionë

euro ose 50.6 për qind të eksporteve të përgjithshme, me një rënie prej -6.2 për qindësh. Partnerë kryesorë për eksport nga vendet e CEFTA-s janë: Shqipëria (19.8 për qind), Serbia (11.5 për qind), Maqedonia (11.1 për qind) dhe Mali i Zi (6.2 për qind). Ndërsa importet nga vendet e CEFTA-s në muajin gusht 2018 arritën në 90,6 milionë euro ose 29.5 për qind të importeve të përgjithshme, me një rritje prej 4.2 për qindësh. Vendet me pjesëmarrje më të lartë për import ishin: Serbia (14 për qind), Shqipëria (7.2 për qind), Maqedonia (5.5 për qind) dhe B&H (2.4 për qind)", theksohet në raportin e ASK-së.

Sipas këtij raporti, eksportet e Kosovës me vendet e tjera të botës arritën në 4,5 milionë euro ose 14.9 për qind.

Si partnerë më të rëndësishëm nga këto vende për eksport vlen të përmendet Zvicra me 9.6 për qind. Ndërsa importet e Kosovës me vendet e tjera të botës arritën në 88 milionë euro ose 28.7 për qind. Vendet me pjesëmarrje më të lartë për import në këtë grup ishin: Turqia (9 për qind) dhe Kina (8.8 për qind).



## Lekaj: Ritestimi do të bëhet për shoferët që përsërisin kundërvajtjet në trafik

PRISHTINË, 24 SHTATOR (ER) - Ministri i Infrastrukturës, Pal Lekaj, ka deklaruar se procesi i pajisjes me licencë për vozitësit në Kosovë do të përshtatet me direktivat e BE-së. Në profilin e vet në "Facebook", Lekaj ka shkruar se tani për tani Kosova është në fazën kur po bëhet krahasimi i legjislacionit me atë të BE-së në fushën e patentshoferit. "Çdo ndryshim që mund të bëhet, në përshtatje të *acquis communautaire*, sigurojmë të gjithë qytetarët se nuk do t'i cenojnë të drejtat e tyre. Ritestimi i njohurive të rregullave të komunikacionit rrugor do të bëhet për të gjithë shoferët të cilët përsërisin në vazhdimësi kundërvajtjet në trafik dhe për

të cilët masat e tjera, si gjobat, tërheqja e pikëve negative dhe pezullimi i përkohshëm i patentshoferit nuk kanë dhënë efekt", ka thënë Lekaj. Ai ka shtuar se këtij testimi do t'i nënshtrohen vetëm shkelësit e shumëfishtë të ligjit dhe rregullave të komunikacionit rrugor. "Konsiderojmë se ky ndryshim, përveç rritjes së sigurisë në komunikacion, do të ndikojë në krijim të besueshmërisë më të madhe të patentshoferit të Republikës së Kosovës, në vendet e Evropës dhe më gjerë. Ky proces është vetëm në fazën e diskutimit dhe qytetarët do të njoftohen me kohë për vendosjen e implementimit të kësaj rregulle", ka deklaruar Lekaj.





# Mbi 5 milionë euro kredi për trajtimin e ujërave të zeza në Podujevë

Qeveria e Kosovës ka marrë kredi në vlerë prej 5.349 milionë eurosh nga Unicredit Bank Austria AG për financimin e projektit të trajtimit të ujërave të zeza në Komunën e Podujevës. Marrëveshja është nënshkruar të hënën nga ministri i Financave, Bedri Hamza, dhe drejtoresha për eksport në UniCredit Bank Austria AG, Sabina Eder



**EPOKA E RE** **Albulena S. MAVRAJ**

**PRISHTINË, 24 SHTATOR** - "Ministria e Financave çdo ditë është duke përmbushur më shumë rolin e saj për sigurimin e mjeteve për financim të projekteve me rëndësi për qytetarët e Kosovës. Si vend në zhvillim, nevojat për investime janë të mëdha, dhe së bashku me partnerët ndërkombëtarë po financojmë projekte jo vetëm të nivelit qendror, por edhe të nivelit lokal", kështu ka thënë ministri i Financave, Bedri Hamza, të hënën, në ceremoninë e nënshkrimit të marrëveshjes për kredi në vlerë prej 5.349 milionë eurosh për financimin e projektit të trajtimit të ujërave të zeza në Komunën e Podujevës, ndërmjet Qeverisë së Kosovës, e përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Qeverisë së Republikës së Austrisë, e përfaqësuar nga Unicredit Bank Austria AG.

Marrëveshja u nënshkrua nga ministri i Financave, Bedri Hamza, dhe drejtoresha për eksport në UniCredit Bank Austria AG, Sabina Eder. Ndërsa me rastin e nënshkrimit të kësaj marrëveshje morën pjesë edhe

ambasadori i Austrisë në Kosovë, Gernot Pfandler, dhe kryetari i Komunës së Podujevës, Agim Veliu.

Ministri Bedri Hamza, duke falënderuar Qeverinë e Austrisë për bashkëpunimin e ofruar, ka pohuar se në të ardhmen do të shtohet ky bashkëpunim. Ai ka thënë se marrëveshje të tilla pritet të nënshkruhen edhe për Komunën e Ferizajt, të Graçanicës, të Shtimes dhe të Istogut, të cilat veç janë në proces. Ministri Hamza ka bërë me dije se këto marrëveshje nënshkruhen pas ratifikimit të amendamentimit të marrëveshjes për bashkëpunim financiar mes dy qeverive në vitin 2017. "Pasi që me ligjet vendore komunat në fjalë nuk i kanë plotësuar kushtet për të marrë kredi, niveli qendror përmes Ministrisë së Financave ka marrë përsipër këtë obligim për kthimin e këtyre kredive", ka thënë Hamza. Ai ka thënë marrëveshja që u nënshkrua ka vlerën 5.349 milionë euro dhe ofrohet me kushte të buta nga Qeveria austriake, që në treg njihet si kredi me normë interesi më të ulët se tregu dhe grejs periudhë më të gjatë se ajo që

ofrohet në treg. "Në praktikë për këtë marrëveshje nuk paguhet interes, mirëpo paguhet vetëm disa tarifa simbolike të garantimit të kredisë dhe zotimit të mjeteve. Në total po flasim për një vlerë prej 1.6 përqindësh që do të paguhet në baza vjetore për huazimin e këtyre mjeteve. Grejs periudha është 4.5 vjet dhe amortizimi bëhet në 23 këste për 11.5 vjet", është shprehur ministri Hamza.

Ambasadori i Austrisë në Kosovë, Gernot Pfandler, duke vlerësuar lart nënshkrimin e kësaj marrëveshje, ka theksuar se pret që gjithçka të shkojë sipas planeve dhe sipas rregullave. Sipas tij, marrëveshja për huan ndërmjet Republikës së Kosovës dhe

Republikës së Austrisë është në procedurë tash e disa vite, ku tani po zbatohen dy komponentët e saj kryesore. Ndërsa drejtoresha për eksport në UniCredit Bank Austria AG, Sabina Eder, ka thënë se UniCredit Bank Austria AG është krenare që është pjesë e kësaj nisme, sepse në njëfarë mënyre i sjellë më afër Kosovën dhe Austrinë. "Kjo është marrëveshja e parë, mirëpo jo e fundit, pasi pritet të vazhdohet edhe me nënshkrimin e marrëveshjeve për komunat e tjera. Banka e Austrisë është krenare që është pjesë e kësaj nisme, sepse në njëfarë mënyre i sjellë më afër Kosovën dhe Austrinë", ka deklaruar Eder.

Kryetari i Komunës së

Podujevës, Agim Veliu, e ka vlerësuar lart ndihmën dhe bashkëpunimin e Qeverisë dhe popullit austriak për ta realizuar këtë projekt dhe gjithashtu kontributin e ministrit Hamza për ta finalizuar nënshkrimin e kësaj marrëveshje. Ai ka theksuar se ky projekt është në të mirë të qytetarëve të Komunës së Podujevës, ku do të krijohen kushtet për trajtim më të mirë të ujërave të zeza. I pyetur nëse do të prolongohet realizimi i kësaj marrëveshje, pasi LDK-ja ka paralajmëruar mocion për rrëzimin e Qeverisë, Veliu ka thënë se LDK-ja do ta përkrahë çdo marrëveshje ndërkombëtare që është në favor të qytetarëve të Kosovës.

## Kundërshtimet e opozitës shtyn diskutimin rreth projektligjit për pagat

**EPOKA E RE** **A. MAVRAJ**

**PRISHTINË, 24 SHTATOR** - Komisioni për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media ka mbajtur të hënën mbledhjen e radhës, në të cilën ishin nëntë pika të rendit të ditës. Por, deputetët e opozitës janë ankuar për agjendë të ngjeshur, duke kërkuar që në këtë takim vetëm të caktohet mbajtja e mbledhjes së radhës e këtij komisioni me dy projektligje dhe të mos shkohet "shkel e shko".

Pas kundërshtimit të opozitës janë hequr nga rendi i ditës pakoja e projektligjeve për reformën në administratën publike, ku përshihet Projektligji për Pagat dhe Projektligji për Transmetuesin Publik.

Deputetja e PSD-së, Shqipe Pantina, ka dhënë vërejtje për numrin e madh të projektligjeve brenda një mbledhjeje. "Gjashtë projektligje janë tepër për një mbledhje. Më shumë se dy projektligje në mbledhje janë shumë. Kjo po shkon shkel e shko, veç kishë po i shqyrtojmë", ka thënë ajo.

Edhe deputeti i LDK-së, Imet Rrahmani, ka deklaruar se nuk ka kushte për të zhvilluar mbledhje të komisionit. "Propozoj që sot të merremi vesh se cilat prej dy projektligjeve t'i trajtojmë në mbledhjen e radhës, sepse sot nuk ka kushte. Për transmetuesin publik kemi vërejtje gati në çdo nen", ka thënë Rrahmani.

Me Pantinën dhe Rrahmanin u pajtua edhe deputeti i LV-së, Adem Mikullovi.

Kryetari i Komisionit për



Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media, Nait Hasani, ka thënë se Projektligji për RTK-në është punuar nga vetë deputetët. Ai ka propozuar që nga rendi i

ditës të hiqen projektligjet që kanë të bëjnë me reformën në administratën publike. "Projektligji për RTK-në e kemi hartuar vetë dhe tash duhet ta çojmë për seancë.

Vetëm për komunën dhe qasjen në dokumente mund të diskutojmë, kurse pikat 4, 5 dhe 6 t'i heqim nga rendi i ditës", ka thënë Hasani.



## Ambasadorja turke shpreh gatishmërinë t'i mbështesë shoqatat e grave në Skenderaj



SKENDERAJ, 24 SHTATOR (ER) - Kryetari i Komunës së Skenderajt, Bekim Jashari, ka pritur në takim ambasadorën e Turqisë në Republikën e Kosovës, Kivilcim Kiliç. Jashari ka treguar se ka pasur një bisedë shumë miqësore me ambasadorën turke, me të cilën ka diskutuar për mundësinë e bashkëpunimit në mes të Komunës së Skenderajt dhe Ambasadës Turke në Prishtinë. Ambasadorja Kiliç u shpreh e gatshme t'i mbështesë shoqatat e grave

me anë të trajnimeve profesionale në fusha të caktuara, nxënësit e shkollave të mesme, studentët tanë me bursa studimi, por edhe në iniciativa të tjera në sektorë të bujqësisë. "Për këtë, natyrisht se i shpreha falënderim dhe e sigurova se do të jemi në shërbim të tyre sa i përket organizimit të sesioneve informuese që do t'i organizojmë me shoqatat e grave, për programet që Ambasada e Turqisë do të ofrojë kurse dhe trajnime profesionale", ka thënë kryetari Jashari.

## Komuna e Rahovecit nis rrënimin e objekteve të vjetra që paraqesin rrezik për qytetarët

RAHOVEC, 24 SHTATOR (ER) - Përmes projektit rrënimi i objekteve pa leje si dhe objekteve të vjetra, në përkujdesjen e Drejtorisë së Inspeksionit të Komunës së Rahovecit ka nisur rrënimi i këtyre objekteve të cilët nga zyrtarët komunalë janë vlerësuar si objekte që paraqesin rrezik për qytetarë. Ecurinë e projektit nga afër e kanë parë kryetari i komunës, Smajl Latifi dhe drejtori i Inspeksionit, Besnik Hoti.

Ky i fundit ka thënë se fillimi i rrënitit të objekteve të vjetra të cilat paraqesin rrezik për qytetarë ka ardhur si rezultat i vlerësimit të bërë nga zyrtarët komunalë. Hoti ka bërë me dije se është rrënuar

objekti i vjetër i shkollës "Mustafë Ibishi" në fshatin Kramovik dhe është bërë rrënimi i objektit të vjetër të shkollës së mesme dhe objektit të stacionit të policisë në fshatin Ratkoc.

Drejtori Hoti ka theksuar se në ditët në vazhdim do të rrënohen objektet e tjera, që përbëjnë rrezik për jetën e qytetarëve dhe objekteve që paraqesin pengesë për zhvillimin infrastrukturor dhe urban në Komunën e Rahovecit. Qytetarët e kanë pritur mirë rrënimin e këtyre objekteve, duke thënë se rrënimi i objekteve të vjetra ka evituar rrezikun i cili ka ardhur nga këto objekte, pasi në vazhdimësi ka lëvizje të qytetarëve afër këtyre objekteve.



## Së shpejti në Malishevë fillojnë edhe tri projekte në fushën e bujqësisë



MALISHEVË, 24 SHTATOR (ER) - Këshilli i Drejtorëve i Komunës së Malishevës ka mbajtur të hënën mbledhjen e radhës, e cila është drejtuar nga kryetari i komunës Ragip Begaj. Në këtë mbledhje është bërë me dije se, krahas realizimit të projekteve të tjera kapitale, shumë shpejt pritet të realizohen edhe tri projekte me rëndësi në fushën e bujqësisë.

Drejtori i Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural,

Murat Hoxha, ka bërë me dije se projekti i parë në fushën e bujqësisë ka të bëjë me përkrahjen me lopë qumështore, projekti i dytë me makina për mbjellje të misrit dhe projekti i tretë për përkrahje me makina për shpërndarjen e plehut kimik. Po në këtë mbledhje drejtorët e drejtorive të tjera kanë raportuar për punët dhe aktivitetet gjatë javës së kaluar dhe për planifikimet për javën në vijim ku, sipas tyre, janë duke vazhduar realizimin e projekteve

dhe planifikimeve për këtë vit. Sipas drejtorit për Buxhet, Valon Mazreku, është hartuar draftbuxheti komunal për vitin e ardhshëm i cili do të diskutohet në Kuvendin e Komunës gjatë kësaj jave. Ndërsa drejtoresha e Sportit, Besartë Kryeziu-Ramaj, ka njoftuar se Komuna e Malishevës është pjesë e "Javës evropiane të sportit" dhe do të jetë pjesëmarrëse në disa prej aktiviteteve që do të zhvillohen gjatë kësaj jave.

## Në Mitrovicë ka filluar ndërtimi i Parkut Botanik

MITROVICË, 24 SHTATOR (ER) - Drejtori për Infrastrukturë dhe Shërbime Publike, Naser Muja, së bashku me zyrtarët e tjerë komunalë kanë inspektuar të hënën përrurimin e punëve në ndërtim të Parkut Botanik.

Drejtori Muja me këtë rast ka kërkuar nga punëkryesi të respektohen kushtet në kontratë dhe projekti të kryhet sipas afatit të paraparë. "Ky park i cili është i një rëndësie të veçantë, si një oazë qetësie dhe çlodhjeje për qytetarët, duhet të kryhet brenda

afatit të paraparë dhe punët duhet të kryhen me përgjegjësi të lartë. Ne si drejtori jemi të vendosur që projektet e tilla të cilat janë në të mirë të qytetarëve t'i kryejmë në mënyrën më të mirë të mundshme", ka thënë Muja.

Kopshti Botanik ka një sipërfaqe prej 70 mijë metrash katrorë, me lloje të ndryshme bimësh, lule dhe bimë të tjera të cilat do të ofrojnë një ambient të mirë për pushim. Ai do të ketë edhe sistem të ujitjes, ulëse për qytetarë, shporta për hedhje të mbetur-

nave dhe shtigje për ecje të këmbësorëve.

Vlera totale e projektit kap shumën prej 240 mijë eurosh dhe është bashkëfinansim i komunës me Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.

Kompania N. Sh. "Ambienti", e cila është kontraktuar për kryerjen e punimeve, është zotuar se punët do të kryhen sipas planit të paraparë dhe brenda dy vjetëve parku do të jetë i gatshëm për qytetarët e Mitrovicës.





# Jashari e Lladrovci takohen me Ahmetin, ftojnë shqiptarët për të votuar pro referendumit



**KËRÇOVË, 24 SHTATOR (ER)** - Kryetari i Komunës së Skenderajt, Bekim Jashari dhe ai i Drenasit, Ramiz Lladrovci, janë takuar me liderin e Bashkimit Demokratik për Integrim (BDI), Ali Ahmeti, me të cilin kanë biseduar për referendumin që do të mbahet më 30 shtator në Maqedoni.

Jashari në llogarinë e vet në "Facebook" ka shkruar se shqiptarët duhet të votojnë pro referendumit për emrin e ri të Maqedonisë. "Takimi me Aliun çdoherë është për t'u mbajtur mend. Së bashku me Ramizin dje e vizituar në shtëpinë e tij dhe bashkëbiseduam gjatë. Sot, më shumë se kurrë, shqiptarët në Maqedoni, por edhe gjithkund ku jetojnë, duhet të jenë të bashkuar rreth ideve dhe interesave madhore për kombin. Interes i tillë

është anëtarësimi në NATO dhe anëtarësimi në BE i secilit shtet ku jetojnë shqiptarët, bashkim me vlerat dhe përkatësinë me botën demokratike perëndimore", ka shkruar Jashari.

Ai ka theksuar se shqiptarët duhet t'i thonë po referendumit të 30 shtatorit. "Këtë duhet ta bëni ju për veten tuaj, familjen dhe kombin. Po NATO, po në BE. Secila votë e juaja ka vlerë. Dilni votoni! Nuk duhet humbur kohë. Vonestarët i ndëshkon historia. Përkatësia jonë perëndimore është e vulosur nga mijëvjeçarët. E kemi thënë dje, e themi edhe sot, ne i takojmë me gjithçka Evropës dhe vlerave të saj", ka thënë kryetari i Skenderajt, Bekim Jashari, i cili ishte i shoqëruar në këtë takim edhe nga kryetari i Drenasit, Ramiz Lladrovci.

## Ministri Gashi: Viti 2019 do të jetë vit i ndryshimit të madh për rininë

Në një ceremoni të organizuar të hënën nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, rreth 250 të rinj janë pajisur me certifikata për trajnimet në kuadër të shkathtësive të buta, duke zhvilluar shkathtësitë e tyre përmes edukimit joformal

### "Epoka e re"

**PRISHTINË, 24 SHTATOR** - Të rinjtë nga shtatë regjionet e Kosovës, nga të gjitha komunitetet që jetojnë në Kosovë, për tre muaj janë trajnuar për zhvillimin e shkathtësive për të aplikuar për punë, si shkrimi i CV-së, letrës motivuese, hulumtimi i konkurseve të punës, për të komunikuar, prezantimi në intervista pune, komunikimi i shkruar, komunikimi verbal, shkathtësitë e mendimit kritik, shkathtësitë e zgjidhjes së problemit dhe kreativitetit. Me këtë rast, ministri Kujtim Gashi ka thënë se kjo ceremoni konfirmon përkrahshimin e MKRS-së për përkrahjen dhe fuqizimin e rinisë në Kosovë. "Jemi vënë bashkërisht në shërbim të komunitetit rinor për ta fuqizuar dhe nxitur pjesëmarrjen e tij në proceset vendim-marrëse dhe për ta mbështetur edukimin e tyre të mëtejshëm duke ndikuar kështu edhe në rritjen e

punësimit të tyre", u shpreh ministri Gashi.

Ai ka shtuar se Kosova ka një proporcion të madh të të rinjve dhe të rejave që kanë potencial për zhvillim. "Prandaj, investimi në rini, në ngritjen e kapaciteteve të tyre, paraqesin disa nga prioritetet kryesore të MKRS-së. Ky investim në rininë tonë është një investim i mirëfilltë që do të ndikojë në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë në punësimin e tyre", ka thënë ministri Gashi, duke shpjeguar se ky trajnim ka përfshirë të rinj nga shtatë regjionet e Kosovës. Ministri ka treguar edhe qëllimin e këtij trajnimi i cili ka pasur synim ngritjen e shkathtësive jetësore për t'i përgatitur të rinjtë për tregun e punës. "Përmes këtyre trajnimeve e moduleve u është dhënë mundësia e përgatitjes së të rinjve për tregun e punës nga të gjitha komunitetet që jetojnë në vendin tonë si shqiptar, serbë, romë, ashkali, egjiptas, turq etj., si dhe kemi



prekur të gjitha grupet e marginalizuara, femrat e reja në zonat rurale dhe personat me nevoja të veçanta", u shpreh ministri Gashi, duke u zotuar se personalisht dhe stafi i tij do të jenë në shërbim të të gjithë të rinjve për të siguruar një perspektivë dhe një jetë më me dinjitet për të rinjtë e Republikës së Kosovës. "Do ta kemi një fond rinor për herë të parë në Kosovë. Nuk do lejojmë që të rinjtë tanë të largohen nga Kosova. E di se është problem i

madh, por bashkë mund t'ia dalim. Konfirmoj para jush se si ministër, por edhe departamenti dhe gjithë kabineti do të jenë në shërbim të tyre. Viti 2019 do jetë vit i ndryshimit të madh për rininë e Kosovës", ka thënë Gashi. Xhevat Bajrami, drejtor i Rinisë në Departamentin e MKRS-së, ka theksuar se Qeveria dhe MKRS-ja ofrojnë programe të ndryshme për ta rritur punësimin e të rinjve. "Ne kemi ofruar programe e trajnime për

t'ju dhënë një shans për tregun e punës. Dua të rithekoj se për ne si departament mbetet prioritet të kemi një rini të shëndoshë", ka thënë ai.

Ndërkaq Besnik Krasniqi, përfaqësues i organizatës, ka theksuar se edhe sektori privat kërkon këto shkathtësi. "Ne që kemi qenë në këtë punë është kënaqësi të punojmë me të rinjtë që kanë një entuziazëm të madh për ta zhvilluar karrierën e tyre", ka thënë Krasniqi.

## Miratimi i Kodit për të miturit, kapitull i rëndësishëm në reformën në drejtësi



**PRISHTINË, 24 SHTATOR (ER)** - Ministri i Drejtësisë, Abelard Tahiri, ka thënë se miratimi i Kodit të drejtësisë për të mitur është projekt i rëndësishëm për avancimin e parimeve dhe standardeve për trajtimin e të miturve. Ai ka thënë se me

miratimin e këtij kodi kanë përmbyllur një kapitull të rëndësishëm në reformën e drejtësisë. "Kuvendi i Republikës së Kosovës ka miratuar përfundimisht Kodin e Drejtësisë për të Mitur, një projekt legjislativ jashtëzakonisht i

rëndësishëm për avancimin e parimeve dhe standardeve më të larta për trajtimin e të miturve. Me miratimin e këtij Kodi kemi përmbyllur një kapitull të rëndësishëm në reformën e drejtësisë, përmes të cilit kemi vendosur trajtim

dinjtore ligjor për të miturit si palë në procedurë, si viktime apo si dëshmitarë, si dhe jemi përkujdesur që të mundësohet risocializimi dhe riintegrimi i tyre i plotë në shoqëri", ka shkruar Tahiri në llogarinë e vet në "Facebook".



## Trumpi: Takimi i dytë me Kimin mund të mbahet shumë shpejt

WASHINGTON, 24 SHTATOR - Presidenti i Shteteve të Bashkuara, Donald Trump, tha se samiti i dytë me udhëheqësin e Koresë së Veriut, Kim Jong Un, ka gjasë të zhvillohet "shumë shpejt".

Duke folur për gazetarët në selinë e Kombeve të Bashkuara në Nju Jork, Trumpi tha se është bërë përparim i jashtëzakonshëm në zbutjen e tensioneve me Phenjanin, rreth programit të tij

me raketa dhe armë bërthamore. "Ka qenë një botë ndryshe. Ka qenë një kohë e rrezikshme", tha Trumpi, duke iu referuar fjalimit të tij në Asamblenë e Përgjithshme të OKB-së, vitin e kaluar, kur e ka kërcënuar Korenë e Veriut me "shkatërrim total", ndërsa Kimin e ka quajtur "njeri të raketave". "Është shumë më ndryshe tash, një vit më vonë. Duket se do ta kemi samitin e dytë shumë shpejt", tha Trumpi.

Ai tha se sekretari amerikan i Shtetit, Mike Pompeo, po punon rreth detajeve të takimit të dytë me Kimin.

Trumpi dhe Kimi janë takuar për herë të parë në Singapor në muajin qershor. Ditë më parë, Kimi kërkoi përmes një letre një takim të dytë me Trumpin. "Siç e dini, Kim Jong Un shkroi një letër, një letër të bukur, duke kërkuar një takim të dytë dhe ne do ta bëjmë këtë", tha Trumpi.



# Pas Brexitit mbahen zgjedhjet?

Derisa kryeministrja Theresa May nuk përjashton mundësinë e zgjedhjeve në Britani pas Brexitit, laburistët kërkojnë referendum tjetër

LONDËR, 24 SHTATOR - Me një fushatë të re, kundërshtarët e kryeministres britanike Theresa May tentojnë ta dobësojnë pozitën e saj. May nuk përjashton mundësinë e zgjedhjeve, ndërsa laburistët kërkojnë referendum tjetër. Në qytetin veriperëndimor britanik Bolton, një nga qendrat e kritikëve të Bashkimit Evropian, është krijuar një lëvizje mbipartiake për mbështetjen e Brexitit - "Save Brexit Campaign". Në krye të kësaj fushate janë ish-ministri për Brexit, David Davis nga radhët e konservatorëve, deputetja e laburistëve Kate Hoey dhe populistin i djathtë Nigel Farage. "Ne nuk kemi votuar për një varg të marrëveshjeve", tha Farage, ish-kryetar i partisë skeptike ndaj BE-së, Ukip, para rreth 1 000 simpatizantëve të mbledhur. "Kjo ishte një votë e rikthimit të vendit tonë në duart tona, nxjerrjes dhe përcaktimit të ligjeve tona, për kontrollin e kufirit të jashtëm, si dhe për pavarësinë e vendit tonë", tha ai.

### Kundërshtimet e May

Davisi ka qenë në verën e kaluar një prej kundërshtarëve të ideve të kryeministres Theresa

May dhe për këtë shkak ka dhënë dorëheqje nga posti i tij. Ai nuk ishte dakord që Britania e Madhe pas marsit të vitit 2019 t'i vazhdojë marrëdhëniet e deritanishme me Bashkimin Evropian. Kryeministrja May mendon se nuk ka ndonjë alternativë më të mirë se plani i ashtuquajtur "Chequers-Plan", të cilin e ka paraqitur në korrik dhe për të cilin ajo mendon se është baza më e mirë për dalje nga BE-ja dhe për raportet e ardhshme me BE.

May mendon se mes në të Britanisë së Madhe dhe BE-së duhet të ketë një zonë të lirë tregtie, se standardet e BE-së duhet të rishikohen dhe se duhet të ketë marrëveshje të veçanta për mallra dhe dogana. Brukseli ka frikë se kjo do të rezultonte me qasjen e sërishme britanike në tregun e brendshëm në BE. Gjithnjë e më shumë po flitet për qëllimet e Britanisë së Madhe dhe Theresa May do që të marrë vetëm gjërat më të mira për vete, ndërkohë që do të heqë dorë nga obligimet. Pyetja kryesore në negociatat e Brexitit është se si do të organizohen kontrollet kufitare mes Irlandës së Veriut dhe Irlandës, e cila do të mbetet anëtare e Bashkimit Evropian.



### Zgjedhje të reja në vjeshtë?

Kryeministrja May ka kërcënuar se në rast se nuk mbështeten idetë e saj, në Britani të Madhe do të organizohen në vjeshtë zgjedhje të parakohshme. Kërcënime ka edhe nga pala kundërshtarë në Londër. Nëse May nuk paraqet planet konkrete për dalje nga BE-ja, deri të hënën, është e mundur që anëtarë të tjerë të kabinetit qeveritar të largohen nga kabi-

neti, si ministrja e Punës Esther McVey apo ministrja e Zhvillimit Penny Mordaunt, shkruan gazeta "Telegraph", por pa bërë publike burimet e këtyre informacioneve.

Ndërsa gazeta "Sunday Times" shkruan se May ndërkohë po e mendon seriozisht edhe mundësinë e zgjedhjeve të reja në Britani të Madhe. Ajo ka kërkuar nga këshilltarët e saj që të merren me këtë çështje, me shpresë se do të rifitojë mbështetjen në zgjedhje.

### Laburistët po pozicionohen

Brexit ishte në qendër të vëmendjes edhe te Partia Laburiste, e cila këtë të diel mbajti konsultime në kongresin partiak. Në takimin e Liverpoolit u mbledhën rreth 13.000 delegatë të kësaj partie opozitare. Krahu evropian i laburistëve kërkon një referendum të ri për Brexit-in. Kërkesa të ngjashme ka pasur edhe më parë.

## Rusia do ta furnizojë Sirinë me sisteme moderne mbrojtjeje

MOSKË, 24 SHTATOR - Rusia njoftoi të hënën se do të furnizojë Qeverinë siriane me sistemet moderne të mbrojtjes raketore S-300, pas rrëzimit të një aeroplani rus nga Siria, një incident që rriti tensionet rajonale në vendin e shkatërruar nga lufta.

Aeroplani ushtarak rus u rrëzua nga sistemet e mbrojtjes raketore të Qeverisë siriane, duke bërë që të 15 personat në bord ta humbnin jetën.

Rusia ia hodhi fajin Izraelit, duke thënë se ishin aeroplanët e tij luftarakë që e kishin ekspozuar avionin rus ndaj

zjarrit kundërajror të Sirisë. Pak para rrëzimit, avionët izraelitë kishin goditur objektiva brenda Sirisë, për të penguar një dërgesë armësh t'i shkonte grupit Hezbollah të mbështetur nga iranianët.

Rusia filloi fushatën e saj në Siri për të mbështetur presidentin

Bashar Assad në vitin 2015. Nga ana e tij, Izraeli është i shqetësuar për ndikimin në rritje të Iranit në Siri, sepse e ka sjellë armikun e tij kryesor më afër kufijve të tij.

Rrëzimi i avionit rus javën e kaluar i ka vënë në provë marrëdhëniet e Rusisë me Izraelin.







## OFERTË PËR SHITJE TË SHTËPISË

Shitet shtëpia dykatëshe, me sipërfaqe prej 218 m<sup>2</sup>, dhe trualli me sipërfaqe prej 410 m<sup>2</sup>.

Shtëpia gjendet në Prishtinë, në lagjen "Aktash I", rr. "Ferhat Draga" nr. 1.

Procedura e transaksionit nga shitësi te blerësi bëhet pas nënshkrimit të kontratës së shitblerjes dhe pagesës së çmimit të kontraktuar, pastaj paluejtshmëria e përshkruar më lart kalon te blerësi.

Çmimi sipas marrëveshjes.

**Informata më të hollësishme  
mund të merren në numrin e telefonit  
001-347-331-8305 në Nju Jork, kurse në Prishtinë  
në celularin 044-166-580.**

**Lume's Details**  
Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 681 898

Sallon Depilimi Lume's Details

lumesdetails

Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi

# AUTOSHKOLLA "RITMO - L"



**Auto Shkolla  
"RITMO - L"  
Prishtinë**

**Eksperiencia jonë  
- përfitimi i juaj.**

**Ju mirëpret:**

**Stafi i Auto Shkollës " Ritmo -L "**

**Tel / kontakt:**

**044 248 173**

**044 200 604**

**044 375 333**



**E rrallë**

## Greqi, ishulli gjen një kaliforniane si kujdestare të maceve

Shoqata "Rescue Cat Little People" ka publikuar një njoftim për punë, ku kërkonte një person i cili mund të kujdesej për gjashtë muaj për 55-60 kotele macesh në Siros, në një ishull grek.



**FOTO E DITES**



Një grup valltarësh performojnë gjatë inaugurimit zyrtar të anijes CMA CGM Antoine de Saint Exupery në Le Havre të Francës.  
/Reuters/

**E jashtëzakonshme**

## Thika e bomba, gjetje të çuditshme në lumenjtë britanikë

Peshkimi duket se ka evoluar në Britani, pasi njerëzit nuk blejnë më kallama të zakonshme për të kapur peshq, por kallama me magnet në kërkim të sendeve me vlerë që përfundojnë në lumenj të ndryshëm. Por teksa sendet me vlerë janë të rralla për t'u gjetur, ky hob i ri ka vënë



në dukje Britaninë e dhunshme, pasi pjesa më e madhe e sendeve të gjetura bëjnë pjesë në kategorinë e armëve.

## BARSOLETA E DITËS



**Hoxha:** Pse kurrë s'po të shoh në xhami?  
**Elektrici:** Valla, hoxhë, as unë ty s'po të shoh në bander!



### Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

Në ora 16:00

## "HOTEL TRANSYLVANIA; Summer Vacation" 3D

I Animuar/Komedi/Familjar; 1 orë 37 min

**Rolet:** Adam Sandler, Selena Gomez, Andy Samberg, Kevin James, David Spade, Steve Buscemi, Molly Shannon, Mel Brooks, etj.

**Regjia:** Genndy Tartakovsky



Në ora 18:00

## "THE DARKEST MINDS"

Fantastiko-Shkencor/Triller; 1 orë 45 min

**Rolet:** Bradley Whitford, Amandla Stenberg, Mandy Moore, Gwendoline Christie, etj.

**Regjia:** Jennifer Yuh Nelson



Në ora 20:00 dhe 22:00

## "THE PREDATOR" 3D,

Aksion/Aventure/Horror; 1 ore 47 min

**Rolet:** Boyd Holbrook, Trevante Rhodes, Jacob Tremblay, Keegan-Michael Key, Olivia Munn, Sterling K. Brown, Alfie Allen, Thomas Jane, Augusto Aguilara, Jake Busey, etj.

**Regjia:** Shane Black



**Për informata dhe rezervime të biletave thirrni FALAS: 0800 22 222 dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.**



**DASHI**

Do të ketë keqkuptime të mëdha në lidhjen tuaj sot dhe jeni ju shkaktari. Gjatë mbrëmjes do të mundoheni të rregulloni gjithçka me një dhuratë.



**DEMI**

Mos u mundoni të bëni shpenzime të paprogramuara sot sepse nuk do të keni mundësi financiare. Çdo gjë me kosto është mirë ta lini për një moment tjetër.



**BINJAKËT**

Nuk keni hije dhe sekrete në të shkuarën tuaj, siç po mundohen t'ju faturojnë. Kujtimet dhe nostalgjinë nuk ka të drejtë t'ju prekë askush.



**GAFORRJA**

Edhe pse dita e sotme është shumë e ngarkuar me punë, nuk ju vjen keq për këtë gjë. Këtë periudhë nuk duhet të qëndroni vetëm duke menduar.



**LUANI**

Ndjenjat dhe personat e dashur sot do të zënë pjesën më të madhe të ditës suaj. Ndihehi të përkëdhelur dhe po ju pëlqen kjo ndjesi.



**VIRGJËRESHA**

Racionaliteti do t'ju shoqërojë sot gjatë gjithë ditës. Në situata të caktuara do të dini t'i bëni zgjedhjet e duhura.



**PESHORJA**

Sot jeni shumë të moderuar në gjykimet tuaja dhe nuk shpreheni pa i parë vetë situatat dhe çastet që mund të krijojnë konfuzion.



**AKREPI**

Në shoqërinë tuaj asnjëherë se keni pasur problem të kërkoni dhe të jepni borxhe të vogla. Në fund të fundit, miqtë janë edhe për këtë gjë.



**SHIGJETARI**

Edhe pse në projektet tuaja nuk do të ketë rezultate të menjëhershme, puna e mirë që keni bërë do të jetë një pasqyrë e qartë e përfundimit.



**BRICJAPI**

Rutina ju ka mbytur sot dhe ndiheni si i zënë në kurth. Nuk do të jetë një ditë e mirë dhe doni që ta kaloni në një ambient të njohur.



**UJORI**

Sot jeni disi lunatike dhe do të nervozoheni edhe pa ndonjë arsye të caktuar. Problem do ta kenë ata që punojnë me ju dhe familjarët.



**PESHQIT**

Vështirësia gjatë ditës së sotme është se si t'i kombinoni aftësitë me praktikën e njerëzve që punojnë me ju. Do të keni pak punë për të bërë.



## Selena Gomez e quan "motër të madhe" Taylor Swiftin



**T**ë dyja janë këngëtare shumë të famshme. Taylor Swifti dhe Selena Gomezi duket se kanë raporte shumë të mira me njëra-tjetrën. Këtë e ka bërë me dije përmes rrjetit social "Instagram", Gomez, ku tha disa fjalë shumë të mira për Swiftin. "Taylor është e mrekullueshme. Unë e dua atë. Ajo

është e mahnitshme. Sot bisedova me të. Ajo është fjalë për fjalë si motra ime e madhe. Unë i tregoj çdo gjë, është kaq e mençur, më frikëson kjo gjë', ka shkruar ajo. Selena dhe Taylori janë shoqe për më shumë se 12 vjet, kur Taylor ishte në lidhje me Joe Jonasin, ndërkaq Selena me Nick Jonasin.

## Aktorja e famshme shfaqet me shumë stil



**A**jo është e njohur për paraqitjet e saj publike me mjaft stil. Aktorja australiane, Cate Blanchett, as kësaj radhe nuk i ka zhgënjyer fansat

gjatë shfaqjes në Javën e Modës në Milano. 49-vjeçarja dukej e përsosur, e veshur me fund të zi, tejet elegante dhe këmbë të bardhë.



## Rita Ora nuk e përjashton mundësinë e bashkëpunimit me Eminemin

**K**ëngëtarja Rita Ora është duke shijuar suksesin e këngës së saj më të re "Let you love me", e cila është pritur mirë nga publiku. Përndryshe, ajo ka bërë me dije se më 23 nëntor do të dalë në shitje edhe albumi i saj më i ri "Phoenix". E ftuar në emi-

sionin e mëngjesit të "Capital"-it, këngëtarja shqiptare ka rrëfyer shumë detaje nga albumi i saj më i ri. Ajo nuk e ka përjashtuar mundësinë se bashkëpunimi i saj i ardhshëm mund të jetë me askënd tjetër veçse me mbretin e rap-it, Eminem.

## Jennifer Lopezi rrëzohet në skenë



**K**ëngëtarja dhe aktorja e famshme Jennifer Lopez ka pasur një përvojë të hidhur gjatë performancës së saj në Las Vegas. 49-vjeçarja ishte duke perfor-

muar këngën e saj "Dance Again", kur u rrëzua. Megjithatë, J. LO këtë gjë e kaloi shumë shpejt pasi u ngrë menjëherë në këmbë dhe të vazhdojë të këndojë si të mos ndodhte asgjë.



**EURO GLASS**  
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON  
Enveri

Adr: Fushë Kosovë  
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336  
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE

"BUJQËSIA"

TEL: 045/82 82 82

PROGNOZA SPORTIVE

BOURNEMOUTH - BLACKBURN

1

WOLVERHAMPTON - LEICESTER

GG

ALDERSHOT - MAIDSTONE UTD

1

# Gashi: Detyra ime është ta rikthej Besën në Superligë

Trajneri Fisnik Gashi është rikthyer në klubin e Besës me mision për ta rikthyer në Superligën e Kosovës. Gashi, i cili e zëvendëson Ismet Munishin në postin e trajnerit, ka thënë se të jesh trajner i Besës është privilegj, por edhe përgjithësi e madhe. "Si ish-futbollist, normalisht se e kam të vështirë ta pranoj se ky klub është në Ligën e Parë, por duhet të punojmë të gjithë maksimalisht për ta rikthyer aty ku e ka vendin. Jam këtu për ta dhënë maksimumin që Besën të rikthej në Superligë", ka thënë Gashi

**EPOKA E RE**

Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 24 SHTATOR - Ish-futbolli legjendar i Besës, Fisnik Gashi, pas një kohe relativisht të gjatë është rikthyer në skuadrën e zezë me mision mjaft të vështirë për ta rikthyer në Superligën e Kosovës në futboll. Klubi pejan e konfirmoi Gashin si pasardhës të trajnerit Ismet Munishi, i cili kohë më parë dha dorëheqje nga pozita e trajnerit, ani pse në këtë klub e kishte marrë me synim për ta rikthyer në Superligë.

Fisnik Gashi ishte trajner i Lugut të Baranit, por ofertën e parë që mori nga Besa nuk hezitoi ta pranojë dhe synimi i tij është që klubi pejan të rikthehet në rangun elitare. Gashi të hënën për "Epokën e re" ka thënë se të jesh trajner i Besës është privilegj, por edhe përgjithësi. "Jam rikthyer në klubin e Besës pas besimit që e kishte kryesia se unë mund ta udhëheq klubin më të suksesshëm pas luftës në Kosovë. Normalisht se është privilegj, por edhe përgjithësi e madhe për të drejtuar një klub me traditë të madhe siç është Besa. Si ish-futbollist, normalisht se e kam të vështirë ta pranoj se ky klub është në Ligën e Parë, por duhet të punojmë të gjithë maksimalisht për ta rikthyer aty ku e ka vendin. Jam këtu për ta dhënë maksimumin që Besën të rikthej në Superligë", ka thënë Gashi, i cili ka lavdëruar fondin, por edhe kushtet që i ka krijuar kryesia për t'i vazhduar garat në Ligën e Parë.

Gashi foli edhe për skuadrat që i sheh konkurrenca në garën për rik-



thim në IPKO Superligë. "Skuadrat që i shoh si pretendente për kreun e tabelës janë Besa, Vëllaznimi, Vushtrria, Dukagjini i Klinës dhe Onixi. Besoj se jemi në avantazh ndaj këtyre rivalëve", ka shtuar ai. Fisnik Gashi ka një karrierë të pasur si futbollist. Ai ishte pjesë e të gjitha grupmoshave në skuadrën e Besës së Pejës me të cilën luajti edhe në ekipin e parë duke fituar tri herë titullin e kampionit në

Kosovë dhe një herë fitues i Kupës dhe Superkupës. Gashi luajti edhe për skuadrën e Trepçës, Elbasanit, Bashkimin e Kumanovës, Milanon e Kumanovës dhe Renovën. Dy herë ishte pjesëmarrës në eliminatorët e garave në UEFA dhe një herë në eliminatorët e Ligës së Kampionëve. Ndërsa nga 2002-n e deri në vitin 2010 ishte pjesë e Përfaqësueses së Kosovës në futboll.

SHKURT

## Trepça '89 beson tek Magani

Pavarësisht prej rezultateve jo të mira në këtë edicion garash, Gugash Magani e ka përkrahjen e drejtuesve të Trepçës '89. "Pas mbledhjes së mbajtur, kryesia e Klubit ia beson vazhdimësinë e punës trajnerit, profesor Gugash Maganit, duke shpresuar se do të kalojmë këtë krizë dhe do t'u kthehemi rezultateve pozitive", thuhet në njoftimin e '89-shit.

## Kololli në formacionin e javës

Benjamin Kololli në mesjavë shënoi gol nga penalltia në Evropa Ligë dhe festimi i tij bëri xhiron e botës, pasi mesfushori ra një zbrazëtirë që ishte pranë tribunës së tifozëve të skuadrës zvicerane. Gjithsesi për të nuk pati ndonjë lëndim. Të dielën Kololli ishte sërish protagonist në fitoren e Zyrrihut, që në shtëpi mundi skuadrën e Lucernit. Lojtari i Kosovës, tashmë 26 vjeç, dha asistimin e golit trepikësh të skuadrës së tij, çka ka bërë që edhe prestigjiozja "Blick" ta përfshijë në formacionin më të mirë të javës.

## Ndërroi jetë ish-futbollisti i Drenicës

Ish-futbollisti i Drenicës, Fidan Gashi, ka ndërruar jetë të hënën. Lajmi është konfirmuar edhe në faqen zyrtare të Drenicës, e cila ka dërguar një telegram ngushëllimi. Arsyet e vdekjes nuk janë bërë të ditura. "Me pikëllim të thellë morëm lajmin për vdekjen e ish-futbollistit tonë, Fidan Gashi. Ai ishte futbollist i KF Drenica para disa vjetësh, duke dhënë kontribut për klubin rreth pesë vjet në grupmosha të ndryshme të klubit. Në emër të kryesisë së KF Drenica, shtabit teknik, menaxhmentit, futbollistëve dhe të gjithë dashamirëve të klubit, shprehim ngushëllimet më të sinqerta për familjen të afërmit, miqtë dhe të gjithë ata që e njohën të riun Fidan Gashi i cili humbi jetën tragjikisht. U presh në paqe, Fidan!", thuhet në telegram ngushëllimin e Drenicës.

## Trajneri Armir Grima do ta vuajë burgun

Gjykata e Krimeve të Rënda ka dhënë masën e sigurisë për gjashtë pjesëtarët e "Grupit Bajri", mes tyre edhe për trajnerin e kombëtares së femrave, Armir Grimën, i arrestuar dy ditë më parë në Shkodër. Grima akuzohet për manipulim të rezultatit të ndeshjeve sportive, pas përgjimeve të bëra. Arrest me burg është masa e marrë nga kjo gjykatë për trajnerin shkodran. Arrestimi i Grimës është bërë pas përgjimeve, ku ka rezultuar se ai ka pasur kontakte me pjesëtarët të "Grupit Bajri" për ndeshjen Tërbuni - Vllzonia B. Pas vendimit të ditës së hënës, pritet që avokatët e Grimës t'i drejtohen Gjykatës së Apelit të Krimeve të Rënda. E njëjta masë është marrë edhe për ish-portierin e Besëlidhjes, Fabiol Rexhepin.

## Kloppi: Atë që bëra me Shaqirin e bëj shumë rrallë

LIVERPOOL, 24 SHTATOR - Jurgen Kloppi ka zbuluar se çfarë bëri për Xherdan Shaqirin pasi e zëvendësoi në pushimin e pjesës së parë ndaj Southamptonit. Anëtori nga Kosova e filloi ndeshjen e tij të parë si startues me Liverpoolin në Ligën Premier dhe arriti të bëjë

një paraqitje fantastike. Ai ishte pjesëmarrës në dy golat e parë të Liverpoolit por, pavarësisht prej kësaj, Jurgen Klopp e zëvendësoi. "Për të qenë i sinqertë, nuk ishte e lehtë. Ndonjëherë është puna ime ta jap lajmin që askush nuk dëshiron ta dëgjojë", ka thënë

Kloppi. "Kjo ishte ajo që ndodhi në pjesën e parë. Ai është një djalë fantastik, ia shpjegova situatën dhe nuk ka ndonjë problem. Zakonisht nuk i shpjegoj zëvendësimet, por mendova se kësaj radhe është e arsyeshme. Është diçka e mirë që e kemi atë,

gjuajta e lirë ishte diçka e madhe. Si lojtar i ri zakonisht ke vështirësi, por ai jo. Ai ka provuar gjithçka. I vetmi problem ishte mbrojtja. Sulmi ishte mirë, por mendova se duhet të bënim më shumë në mbrojtje. Ai bëri mirë dhe më pëlqeu", ka shtuar Kloppi.






## Kastrati: E dua Kroacinë sepse është më e fortë se Kosova dhe Shqipëria

ZAGREB, 24 SHTATOR - Skuadra e Lokomotivës së Zagrebit ka marrë një fitore të rëndësishme përballë Rijekës. Në këtë sfidë startuan që nga minuta e parë dy shqiptarët, Myrto Uzuni dhe Lirim Kastrati, me këtë të fun-

dit që shënoi dhe një supergol. Ndeshja përfundoi me rezultatin e përgjithshëm 2 me 0 dhe me këtë fitore skuadra e Lokomotivës ngjitet në vendin e dytë të klasifikimit. Autori i golit, Kastrati, i lindur në

Malishevë, ka shprehur dëshirën e çuditshme për ta refuzuar Kosovën dhe Shqipërinë. Në një deklaratë për mediet kroate, ai ka deklaruar se pret ftesë nga nënkampionët e botës. "Nuk

kam vendosur ende për kombëtaren, por dua të luaj për Kroacinë, sepse është më e fortë se Kosova dhe Shqipëria", është shprehur lojtari që aktualisht është pjesë e Kombëtares U-19 të Kosovës.



## Cech: Me Wengerin kishim harruar se si fitohej

LONDËR, 24 SHTATOR - Arsenali arriti të dielën një fitore mjaft të rëndësishme përballë Evertonit, me shifrat 2-0. Një fitore, që është e pesta radhazi për "topçinjtë" në të gjithë competitionet dhe e katërta në Premierë Ligë. Në afatin kalimtar të verës Arsenali transferoi nga Bayer Leverkuseni portierin gjerman Bern Leno por, me sa duket, trajneri spanjoll Unai Emery vijon të besojë tek aftësitë e veteranit Petr Cech. 36-vjeçari vijon të jetë titullar në portën e Arsenalit, teksa në kampionat ka qenë titullar në çdo sfidë. Pikërisht portieri çek ka folur për mediat angleze pas sfidës ndaj Evertonit, ku është shprehur se nën drejtimin e Arsene Wengerit Arsenali kishte harruar se si të fitonte në Premierë Ligë. "Për çdo klub që ka fituar tituj në vitet e fundit, çdokush di se si të arrijë të fitojë qoftë edhe një ndeshje shumë të vështirë. Mund ta shohësh në çdo sport. Shikoni Tajger Uds në golf. Kanë kaluar 5 vjet që kur ai ka fituar një trofe madhor. Sa më shumë kohë kalon aq më e vështirë bëhet. Arsenali ka më shumë se 10 vjet



pa fituar kampionatin, prandaj duhet të shohësh se çfarë duhet të bësh për t'u rikthyer fitues", ka thënë Cech. Gjithashtu, portieri foli edhe për trajnerin e ri, Unai Emery. "Me trajnerin e ri po ndryshojmë dhe po përmirësohemi shumë. Pak e nga pak po përvetësojmë edhe mentalitetin e fituesit, i cili na ka munguar si

klub. Nën drejtimin e Wengerit kishim harruar se si mund të fitohet Premierë Liga. Në atë kohë më dukej sikur tek Arsenali ishte më e rëndësishme loja sesa pikët. Tani ne mund të fitojmë edhe sfida me lojë jo fort të mirë, por tri pikët janë ato çka numërohen në fund", ka përfunduar Cech.

## Vetteli: Askush si Raikkoneni

BERLIN, 24 SHTATOR - Sebastian Vettel dhe Kimi Raikkonen, një dyshë fantastike në pistë e jashtë saj prej katër sezonesh dhe këtë e vërtetojnë fjalët e pilotit gjerman, i cili kurrë nuk e ka fshehur respektin për finlandezin. Raikkoneni është në sezonin e fundit me Ferrarin dhe vendin e tij do të marrë i riu Charles Leclerc. Ky i fundit konsiderohet një talent i madh, por Vetteli mendon ende për shokun aktual të skuadrës: "Kimi është shoku i skuadrës më i mirë që kam pasur ndonjëherë. Me të ka pasur gjithmonë respekt reciprok që në fillim dhe nuk kemi pasur kurrë probleme. Trishtohem kur mendoj se Kimi nuk do të jetë më pjesë e skuadrës prej vitit të ardhshëm". Vetteli flet edhe për Leclerc: "Është një mundësi e madhe për Charles. Është prej shumë kohësh në programin 'junior' të skuadrës, ndaj është



diçka e bukur të shohësh ku ka mbërritur. Natyrisht bëhet fjalë për një ndryshim, por për momentin nuk e mendoj këtë gjë. Jam i përqendruar te garat e këtij sezoni. Çdo njeri është ndryshe, do të ketë dinamika të reja, por mendoj se Leclerc është një djalë i mbarë dhe shpresoj të përshtatet mirë. Do

të bëjmë maksimumin për të punuar me të. Duam të punojmë bashkë si një skuadër". Leclerc është vetëm 20 vjeç: "Nëse je i shpejtë dhe ke talent, moshë nuk ka rëndësi. Leclerc e meriton të jetë në Formula 1 dhe është fantastike që i jepet mundësia të garojë në një skuadër të madhe si Ferrari".

### SHKURT

#### Pogba: Në 'Old Trafford' duhet të sulmojmë më shumë

Mesfushori Paul Pogba është i pakënaqur me lojën e Manchester Unitedit kur kjo skuadër po luan si vendëse. Francezi ka thënë se Unitedi në "Old Trafford" duhet vetëm të sulmojë. "Luajtmë në shtëpi dhe duhet të kishim zhvilluar një lojë shumë më të mirë ndaj Wolverhamptonit. Kur luajmë në shtëpi duhet të sulmojmë, të sulmojmë dhe vetëm të sulmojmë. Ky është 'Old Trafford' dhe ne këtu duhet të sulmojmë pasi kundërshtarët trembën kur ne jemi përpara", ka thënë Pogba. "Unë nuk jam trajneri i skuadrës, por duhet të tregojmë që kemi më shumë mundësi në lojë, kështu së paku mendoj unë. Duhet të lëvizim më shumë dhe më mirë", ka deklaruar Pogba.

#### Allegri kritikon Bonuccin

Trajneri i Juventusit, Massimiliano Allegri, e ka kritikuar Leonardo Bonuccin për faktin se po kalohet lehtë nga kundërshtarët. "Deri tani kemi pësuar shumë dhe Bonucci nuk ka qenë në formën e tij më të mirë. Në Valencia më pëlqeu, por ndoshta ai ka harruar se si mbrojmë ne te Juventusit. Leonardo është një profesionist, por duhet të jetë më i qetë dhe të nisë të studiojë që të mos kalohet aq lehtë nga rivali dhe të mbulojë duke përdorur edhe ndihmën e shokëve të ekipit. Nuk ka nevojë të marrë përsipër shumë situata personale. Thjesht, duhet të kthejë kokën pas dhe t'i studiojë metodat e së kaluarës", ka thënë Allegri.

#### Grosskreutz, Gotzes: Shko në Liverpool

Ish-bashkëlojtari i Mario Gotzes, Kevin Grosskreutz, ka vlerësuar se ylli gjerman duhet të mendojë për një largim të mundshëm nga Borussia Dortmund. Madje ish-lojtari i Kombëtares së Gjermanisë ka thënë se Gotze duhet të transferohet në janar te Liverpooli. "Më vjen shumë keq për momentin që po kalon Mario Gotze. Në Brugge, e gjithë skuadra nuk luajti mirë, por të gjithë kritikantët shkuan për të. Do të ishte më mirë që ai të largohet gjatë merkatos së dimrit, si e vetmja mënyrë për ta rilindur karrierën. Mundësisht te Liverpool. Kloppi e njeh shumë mirë dhe mendoj se është ndër të vetmit që mund ta marrë maksimumin nga Gotze", ka thënë Grosskreutz.

#### Di Francesco rrezikon shkarkimin

Trajneri i Romës, Eusebio Di Francesco, rrezikon të shkarkohet, pasi rezultatet e skuadrës nga kryeqyteti italian janë negative në këtë edicion. Pesë pikë në pesë ndeshjet e para janë shumë pak për skuadrën e Romës, prandaj mediet italiane raportojnë se drejtuesit Romës po mendojnë për një trajner të ri. Në listë janë emrat e Blanc, Sousa, Montella dhe Conte.

#### Barcelona: VAR-i duhet të përdoret në mënyrë korrekte

Në minutën e 33-të të ndeshjes mes Barcelonës dhe Gironës, që përfundoi 2-2, nisën polemikat. Përballë zonës së vendësve, Lenglet goditi me bërryl Pere Ponsin, pasi ky i fundit kishte shkakuar faull. Gjyqtari Gil Manzano shkoi të shikonte edhe një herë incidentin pasi vëzhguesit e VAR-it e këshilluan ta bënte këtë gjë. Pasi shikoi pamjet, gjyqtari vendosi të ndëshkonte me të kuq mbrojtësin e Barcelonës. Me një vendim të tillë futbollistët dhe stafi i Barcelonës nuk ishin aspak dakord. Sergio Busquets u shpreh pas ndeshjes se VAR-i duhet përdorur në mënyrë korrekte. "Lenglet bën një lëvizje natyrale, nuk është agresion. Pati kontakt, por topi ishte në tokë. VAR-i duhet të ketë të njëjtin kriter për të gjithë", theksoi mesfushori i Barcelonës. Edhe trajneri Ernesto Valverde nuk është dakord me kartonin e kuq: "Nuk jam dakord me VAR-in. Mendova se gjyqtari po shikonte nëse sulmuesi goditi mbrojtësin tim. Nuk kishte fare agresion".





**ОПШТИНА ГРАЧАНИЦА**  
Одељење за образовање и културу  
**KOMUNA E GRAÇANICËS**  
Departamenti i Arsimit dhe Kulturës  
Грачаница/ Graçanicë

На основу члана 8. став 1. Закона о раду (Бр.03/3-212) и члана 4. Административног унутства (МРСЗ) Бр.07/2017 за регулсање процедура конкурса у јавном сектору, Одељење за образовање и културу општине Грачаница дана 25.09.2018.године, објављује:

Нë базë тë ненит 8 параграфи 1 тë Лигит тë Punës (nr. 03/L-212), dhe тë ненит 4 тë Udhëzimit Administrativ (MPMS) nr. 07/2017 për rregullimin e procedurave të konkurimit në sektorin publik, Departamenti i Arsimit dhe Kulturës së Komunës së Graçanicës, më datën 25.09.2018. shpall këtë:

## ЈАВНИ КОНКУРС KONKURS PUBLIK

### 1. Назив радног места: Професор географије

Услови:  
Завршен факултет: Географија

Број радних часова: 20 недељно  
Месечна бруто плата: 459,95 €

Број извршилаца: 1

Период закључења уговора: Пробни рад у трајању од (3 месеца), уз могућност продужења.

### 1. Titulli i vendit të punës: Profesor i gjeografisë

Кухетет:  
-Тë ketë kryer Fakultetin – drejtimi Gjeografia

Numri i orëve: 20 orë në javë  
Paga mujore bruto: 459,95 €

Numri i ekzekutuesve: 1

Periodha e përfundimit të kontratës: Puna provuese për një periudhë prej (3 muaj), me mundësi vazhdimi.

### 2. Назив радног места: Професор уставног права

Услови:  
-Завршен правни факултет

Број радних часова: 20 недељно  
Месечна бруто плата: 459,95 €

Број извршилаца: 2

Период закључења уговора: Пробни рад у трајању од (3 месеца), уз могућност продужења.

### 2. Titulli i vendit të punës: Profesor i drejtës kushtetuese

Кухетет:  
-Тë ketë kryer Fakultetin Juridik

Numri i orëve: 20 orë në javë  
Paga mujore bruto: 459,95 €

Numri i ekzekutuesve: 2

Periodha e përfundimit të kontratës: Puna provuese për një periudhë prej (3 muaj), me mundësi vazhdimi.

### 3. Назив радног места: Наставник биологије

Услови:  
Завршен факултет: Биологија, Пољопривредни факултет или сродне области

Број радних часова: 20 недељно  
Месечна бруто плата: 397,51 €

Број извршилаца: 2

Период закључења уговора: Пробни рад у трајању од (3 месеца), уз могућност продужења.

### 3. Titulli i vendit të punës: Arsimtar i biologjisë

Кухетет:  
- Тë ketë kryer Fakultetin - drejtimi Biologji, Fakultetin e Bujqësisë apo nga fusha të ngjashme

Numri i orëve: 20 orë në javë  
Paga mujore bruto: 397,51 €

Numri i ekzekutuesve: 2

Periodha e përfundimit të kontratës: Puna provuese për një periudhë prej (3 muaj), me mundësi vazhdimi.

### 4. Назив радног места: Психолог

Услови:  
Завршен факултет: Психологија

Број радних часова: 40 недељно  
Месечна бруто плата: 380,25 €

Број извршилаца: 1

Период закључења уговора: Пробни рад у трајању од (3 месеца), уз могућност продужења.

### 4. Titulli i vendit të punës: Psikolog

Кухетет:  
-Тë ketë kryer Fakultetin - drejtimi Psikologji

Numri i orëve: 40 orë në javë  
Paga mujore bruto: 380,25 €

Numri i ekzekutuesve: 1

Periodha e përfundimit të kontratës: Puna provuese për një periudhë prej (3 muaj), me mundësi vazhdimi.

### 5. Назив радног места: Педагог

Услови:  
-Завршен факултет: Педагогија

Број радних часова: 40 недељно  
Месечна бруто плата: 380,25 €

Број извршилаца: 1

Период закључења уговора: Пробни рад у трајању од (3 месеца), уз могућност продужења.

### 5. Titulli i vendit të punës: Pedagog

Кухетет:  
-Тë ketë kryer Fakultetin - drejtimi Pedagogji

Numri i orëve: 40 orë në javë  
Paga mujore bruto: 380,25 €

Numri i ekzekutuesve: 1

Periodha e përfundimit të kontratës: Puna provuese për një periudhë prej (3 muaj), me mundësi vazhdimi.

### 6. Назив радног места: Администратор

Услови:  
Завршена виша школа из области: економије, права, менаџмента.

Број радних часова: 40 недељно  
Месечна бруто плата: 350,95 €

Број извршилаца: 5

Период закључења уговора: Пробни рад у трајању од (3 месеца), уз могућност продужења.

### 6. Titulli i vendit të punës: Administrator

Кухетет:  
-Тë ketë kryer shkollën e lartë nga fusha: e ekonomisë, së drejtës, të menaxhmentit

Numri i orëve: 40 orë në javë  
Paga mujore bruto: 350,95 €

Numri i ekzekutuesve: 5

Periodha e përfundimit të kontratës: Puna provuese për një periudhë prej (3 muaj), me mundësi vazhdimi.

### 7. Назив радног места: Возач

Услови:  
-Завршена средња школа, поседовање возачке дозволе D-катеорије

Број радних часова: 40 недељно  
Месечна бруто плата: 302,62 €

Број извршилаца: 1

Период закључења уговора: Пробни рад у трајању од (3 месеца), уз могућност продужења.

### 7. Titulli i vendit të punës: Vozitës

Кухетет:  
-Тë ketë kryer shkollën e mesme, posedimi i patent shoferi i kategorisë D

Numri i orëve: 40 orë në javë  
Paga mujore bruto: 302,62 €

Numri i ekzekutuesve: 1

Periodha e përfundimit të kontratës: Puna provuese për një periudhë prej (3 muaj), me mundësi vazhdimi.

### 8. Назив радног места: Помоћно особље

Услови:  
Завршена средња школа

Број радних часова: 40 недељно  
Месечна бруто плата: 272,88 €

Број извршилаца: 8

Период закључења уговора: Пробни рад у трајању од (3 месеца), уз могућност продужења.

### 8. Titulli i vendit të punës: Staf ndihmës

Кухетет:  
-Тë ketë kryer shkollën e mesme

Numri i orëve: 40 orë në javë  
Paga mujore bruto: 272,88 €

Numri i ekzekutuesve: 8

Periodha e përfundimit të kontratës: Puna provuese për një periudhë prej (3 muaj), me mundësi vazhdimi.

**Кандидат мора бити: пунолетан, пословно способан и да није осуђиван за кривична дела која га чине неподобним за вршење посла и за која се изриче казна затвора у трајању од најмање 6 месеци.**

**Кандидат дует тë jetë: madhor, i aftë për punë dhe që të mos jetë i dënuar për vepra penale, të cilat e bëjnë atë të papërshtatshëm për kryerjen e punës dhe për të cilat mund t'i shqiptohet dënimi me burg në një kohëzgjatje më pak se 6 muaj.**

Сваки кандидат уз апликацију прилаже: фотокопију важеће личне карте, оверену фотокопију дипломе, доказ о радном искуству, увреће да није под истрагом. Secili kandidat duhet ta paraqet së bashku me aplikacion: kopjen e letërnjoftimit të vlefshëm, fotokopjen e verifikuar të diplomës, dëshminë e përvojës së punës, vërtetimin që nuk është nën hetim.

**Конкурс остаје отворен 15 дана од дана објављивања. Апликације се могу преузети и поднети сваког радног дана у општини Грачаница у периоду од 08:00 до 16:00 часова.**

**Кандидати могу своје апликације да подносе у периоду од 25.09.2018. до 09.10.2018.године.**

**Конкурс мбетет и hapur 15 ditë nga dita e shpalljes në mjetet e informimit publik. Aplikacionin mund ta merrni dhe ta dorëzoni çdo ditë pune në Komunën e Graçanicës prej orës 08:00 deri në orën 16:00.**

**Кандидатët mund t'i dorëzojnë aplikacionet e tyre në një periudhë prej 25.09.2018. deri më 09.10.2018.**

**Напомена: Неблаговремена и некомплетна документација неће бити разматрана. Vërejtje: Dokumentacioni i dorëzuar pas afatit të fundit dhe i pakompletuar nuk do të merret në konsiderim.**





Republic of Kosovo  
Millennium Foundation Kosovo  
Specific Procurement Notice  
Dig Data Challenge Evaluator/Consultant for  
Millennium Foundation Kosovo  
RCQ-MFK- 017

